


RILINDJE



Megjithëse njeriu në këtë jetë ka vetëm një jetë, ai mund të rilindë sërish në këtë botë. Mishërimi dhe rimishërimi siç i beson dikush janë vetëm besëtytni, pra s'ka aty rilindje. Kur njeriu të vdesë në këtë botë do të dëshirojë rilindjen dhe do të thotë: ***"...O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!" Kurrresi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distançë periodike) deri në ditën kur ringjallen."*** (Muminun 99-100). Që të mos e arrijmë këtë dëshpërim të pasosur duhet të meditojmë, nëse Allahu jep mundësi tjera për rilindje.

Muajin e Ramazanit, që po e përcjellim tani gjithsesi ishte një shans i mirë për rilindje. Rilindjen e zemrës, shpirtit, sjelljes, besimit, bindjes dhe të kënaqësisë. Nëse i lexuam fjalët e Zotit me vëmendje na u rrëqethën zemrat, nëse u penduam për gabimet e bëra e liruam shpirtin nga nxehtësia e gjynaheve, nëse agjëruam, si na ka mësuar i Dërguari, lavdërimi dhe paqja qoftë me të, e përmirësuam sjelljen, nëse falëm namazin e teravisë dhe të natës me përkushtim e përulje e rritëm besimin, me leximin dhe dëgjimin e ligjëratave të ndryshme na u rrit bindja dhe nëse të gjitha këto i bëmë na u shtua kënaqësia se Allahu është Zoti ynë, Islami është feja jonë dhe Muhamedi është profeti ynë.

Elemente këto të gjitha të mjaftueshme për të kuptuar, se çdo formë tjetër e jetës në këtë botë, ku nuk gjenden ato përparësi dhe vlera nuk ka shije e as lumturi të vërtetë. Nëse me të vërtetë i shohim, se i kemi fituar, atëherë themi se ajo është rilindje për ne. S'kemi pse të mbajmë shpresa të zbrazëta sikurse fjalët: Sikur të kthehesha më i ri do të bëja këtë e do të bëjaatë..., sikur të lindja edhe një herë nuk do lejoja këtë apo atë... Tashmë do të bësh një jetë të re ndryshe nga e mëparshmja dhe je i bindur se jeta asisoj të ofron mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit. Ke punuar prandaj – me lejen e Allahut – ke ndjerë në brendinë tënde çlirimin e veçantë që vezullon në fytyrën dhe sjelljen tënde.

Ai që ka fituar këtë, le të jetë mirënjohës ndaj të Gjithëmëshirshmit, duke e shprehur atë me zemër, gjuhë dhe vepra. Atëherë ajo kënaqësi sa vjen e rritet derisa ta takosh Allahun me besimin e palëkundur për t'i përjetuar shpërblimet që Ai i ka përgatitur për njerëzit e devotshëm. O Allah, na bëj të sigurtë në fjalët dhe veprat tona!

Në emër të redaksisë: Omer BERISHA

AKTUALE

3-5 | DEBATET NË INTERNET DHE PASOJAT

6-7 | IKJA NGA SELEFIZMI!

8-9 | BLIC LAJME

SFIDA

10-12 | RRUGA KRYESORE

AKIDE

13-16 | JAM I KËNAQUR ME MUHAMEDIN SI I DËRGUAR

DRITARE

17-20 | SIPAS VENDIT BËHET KUVENDI...

21-22 | FEJA ËSHTË KËSHILLË

23-25 | TEVESULI DHE AJETI

"...DHE KËRKONI EL-VESILEH TEK AI..."

26-30 | KAM FRIKË!

FIKH

31-34 | BIDATET, LLOJET E TYRE DHE GJYKIMI I ISLAMIT MBI TO

EKONOMI

34-39 | HUAJA DHE DISA NGA DISPOZITAT E SAJ

FAMILJA

40-42 | ËNDRRAT E GRAVE

43-45 | MBAJENI FRYMËN E RAMAZANIT GJALLË!

TEFSIR

46-48 | PËRSOSMËRIA E FESË ISLAME

HADITH

49-51 | PO UA LË AMANET DY GJËRA

THESARE

52-55 | SYNETIA NGA ASPEKTI MJEKËSOR

AVANCIMI PERSONAL

56-57 | PERCEPTIME NDAJ LUMTURISË

FETVA DHE KONSULTIME

58-60 | A KA BIDAT TË MIRË?

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,
Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: albislam@albislam.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denarë)

xhirollogaria: 0270100245547

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro etj.)

Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T.: KOB5MK2X

IBAN: MK07300701002455425

numri tatimor: 4030008038784



DEBATET NË INTERNET DHE PASOJAT

Mungesa e etikës dhe e qëndrimit konstruktiv është një nga të metat themelore e debateve të brendshme, por në veçanti e atyre që po zhvillohen në internet. Facebook-u, listat e e-mailave dhe blogjet e ndryshme e kanë rritur shpejtësinë e transmetimit të informacionit dhe të komunikimit publik, por etika e komunikimit ka mangësi të theksuara.

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

Mungesa e etikës dhe e qëndrimit konstruktiv është një nga të metat themelore e debateve të brendshme, por në veçanti e atyre që po zhvillohen në

internet. Facebook-u, listat e e-mailave dhe blogjet e ndryshme e kanë rritur shpejtësinë e transmetimit të informacionit dhe të komunikimit publik, por etika e komunikimit ka mangësi të theksuara.

Ajo çka ndodhi në dy promovime të organizuara në librarinë “E Përshtatshme” përpara pak kohësh në Tiranë ishin me të vërtetë dobiprurëse për të gjithë ne, që aspirojmë të kemi sadopak një jetë intelektuale. Kam parasysh promovimin e librit të **Edvin Camit**: “*Gëtja mes Perëndimit dhe misticizmit oriental*”, si dhe një reviste krejtësisht të re me titullin shumë domethënës: “NJË”, që drejtohet nga vëllai jone **Edison Çeraj**. Të dy këta vëllezër janë kapacitete në fushat e tyre ku veprojnë si dhe janë pedagogë universiteti.

Ajo çka ishte e veçantë në këto promovime ishte debati dhe diskutimet që u hapën më mbrapa dhe mexhlisi jashtëzakonisht interesant që u krijua prej diskutimeve tejet të vlefshme. Ato qenë me të vërtetë të vlefshme për shkak të disa përmasave etike tejet të larta që u reflektuan aty dhe kritikave krejtësisht dashamirëse që u bënë. Kjo gjendje me solli ndërmend mexhliset e hershme, kur njerëzit e dijes (qoftë nxënës apo dijetarë, apo hoxhallarë) mbledheshin dhe garonin, se kush mund të ishte më i zoti në të shprehurit e mendimit të tij në lidhje me temën që diskutohej dhe arritja e rezultateve pozitive në përfundim.

Me këtë desha të them se këto lloj mexhlisesh na mungojnë krejtësisht këtu në hapësirën tonë dhe këto promovime e konfirmuan këtë gjë. Por një problem tejet i ndjeshëm së fundmi janë debatet që hapen në e-mail listat e internetit, si dhe së fundmi në rrjetin social të Facebook-ut, ku etika e debatit dhe e kundërshtimit të njëri-tjetrit lë shumë për të dëshiruar. Nuk po mundohem të sjell shembuj këtu, sepse me të vërtetë që do të ishte humbje kohe për të gjithë, kur pjesa më e madhe e jona janë të anëtarësuar nëpër listat e ndryshme. Sa për diskutimet në forumet tona internetare, ato nuk i plotësojnë

“...Personat që diskutojnë meqenëse janë me formime të ndryshme shkollore gjithmonë përpiqen t'i shikojnë gjërat sipas shkollimit që kanë marrë, apo po marrin...”

kushtet e një mexhlisi të vërtetë apo siç e parashoh unë, për disa arsye:

1: janë krejtësisht virtuale
2: njerëzit që debatojnë në të shumtën e rasteve nuk e njohin nga afër njëri-tjetrin dhe kjo le shteg për të dëshiruar.

3: personat që diskutojnë e bëjnë këtë nga vende të ndryshme dhe shumë herë reflektojnë pa dashje gabime me mosnjohjen e duhur të problemit për të cilin diskutohet apo debatohet.

4: personat që diskutojnë meqenëse janë me formime të ndryshme shkollore gjithmonë përpiqen t'i shikojnë gjërat sipas shkollimit që kanë marrë, apo po marrin (Një avokat sheh bazën ligjore të gjithçkaje, një imam e sheh nga pikëpamja fetare, një sociolog sipas shkollave përkatëse sociologjike etj.)

5: nëse personat që diskutojnë e bëjnë këtë nga dy vende të ndryshme, bie fjala- një shqiptar nga Amerika me një shqiptar nga Shkupi, apo Tirana, apo Prishtina, do të kishim nga një anë njërin nga diaspora dhe në anën tjetër me dy vendalinj puro, që kanë probleme të tjera nga ato të emigrimit, si dhe me një shqiptar që jeton në një qytet si Shkupi, ku më të paktën ky qytet banohet nga dy kombësi (pra, diskutimi mund të marri një kolorit të paparë në bazë të këtij ekuacioni të tillë logjik.).

Pasi numërova pesë arsye që e diktojnë krejt sfondin kuptimor të diskutimit dhe të debatit në forumet internetare, FCB apo e-mail listat do të merrja në shqyrtim vetë mexhlin, jo si etimologji fjale, por si realitet.

Mexhli ndërtohet në tre përmasa, le të përdorim këtë term të gjeometrisë jo-euklidiane. Njerëz të caktuar, që mbledhen në një vend të caktuar në një kohë të caktuar për të diskutuar për një temë apo problem të caktuar. E parë nën këtë këndvështrim mund të themi se rrethanat përbërëse janë të cingëra dhe nëse do të fillonim të bënim analogjitë, atëherë të gjithë së bashku do të vërenim:

1: a) **Njerëzit** lëvizin nga listat, ku mund të anëtarësohen dhe mund të largohen sipas dëshirës. Gjithashtu, megjithëse mund të jenë të anëtarësuar ata nuk marrin pjesë dhe diskutantët nuk mund ta dinë nëse heshtjen e tyre mund ta marrim si pohim apo abstenim.

b) Pjesëmarrësit në një mexhli marrin pjesë më gjallërisht edhe me heshtjen e tyre, duke u interpretuar kjo heshtje si pranim ndaj mendimit dominues.

2: **Vendi**: është i përbashkët, lista e-mailit dhe në mexhli vendi ku do të diskutohet, por këtu mungon elementi i kontaktit fizik, pra, diskutimi apo debati zhvillohet pa pasur ndonjë kontakt fizik të drejtpërdrejt, për pasojë këtu analogjia nuk mund të themi se vendoset e plotë.

3: **Koha**: Diskutimi apo debati nuk mund të zhvillohet në të njëjtën kohë, pra, është shumë më i shtrirë në kohë.

4: **Problemi** apo tema e caktuar: Kjo është krejtësisht e përbashkët, por gjykimet dhe mendimet është e vështirë të jenë të përbashkëta dhe nuk mund të vijnë drejt unifikimit për shumë arsye të tjera (që kanë të bëjnë edhe me bindjet e njerëzve, të cilat janë shumë të

“...Kështu nuk mund të habitemi, se si nëpër listat tona bisedat personalizohen krejt, kur nuk kanë të bëjnë me ne drejtpërdrejt, por me punët tona...”

rëndësishme, ndërsa nuk janë këto ato që po shqyrtojmë këtu), por që vështirësohen maksimalisht për të gjitha arsyet që i kam përmendur më sipër.

Gjithashtu një komponentë tejet e rëndësishme është etika e debatit dhe e mospërputhjes (ihtilafit), që i mungon në më të shumtën e rasteve debateve tona. Kështu nuk mund të habitemi, se si nëpër listat tona bisedat personalizohen krejt, kur nuk kanë të bëjnë me ne drejtpërdrejt, por me punët tona. Problemet tona janë po ato, mbeten po ato dhe do të mbeten po ato, po nuk i zgjidhëm në mënyrën e duhur, por edhe se ne deri tashti nuk jemi përpjekur aq sa duhet, duke e drejtuar vëmendjen në bazë të një utilitarizmi ordiner që mund të vërehet qartas. Ndërkaq një pjesë e këtyre problemeve mund të shmangen shumë mirë, kur ne të reflektojmë gjallërisht etikën e lartë islame, të cilën neve duhet ta fitojmë vazhdimisht nëpërmjet shembullit të njeriut tonë më të dashur Muhamedit *alejhi salatu ue selam*, si dhe të shokëve të tij të afërt. Gjithashtu njohja e etikës së ihtilafit (mospërputhjes) do të ishte shumë me vend për të shtuar kapacitetin tonë të debatit. ■

IKJA NGA SELEFIZMI!

Nuk po flasim për selefizmin si ndonjë xhemat i caktuar (apo disa xhemate), apo si ndonjë metodologji konkrete, pasi ai është një metodologji dhe referencë e vetme: Kurani, Suneti dhe gjeneratat më të mira përpara se të derdhej ai lumë nëpër degë të tjera aty-këtu, që gjithmonë largohen nga shtrati i sigurt

DR. MUHAMED EL ABDE

Po flasim këtu për përmbajtjen dhe jo për emrin. Kuptimin e Sunetit dhe Ndjekësit e Sunetit, sepse sot, disa njerëz po tentojnë ikjen nga Selefizmi, e ky është një emër që i kaploi pa e dashur ata, madje ëndërrojnë të zhvishen nga ai emër, sepse ai është diçka e vjetruar prandaj duhet ta heqim qafe. Sipas tyre ai është i papërshtatshëm, për shkak se opinioni po e shfrytëzon atë me ide dhe pretendime të ashpra në sulm kundër muslimanit dhe na ka mbetur vetëm të mbrohemi.

Kemi si qëllim selefizmin si dogmë dhe ndjekje të metodologjisë së caktuar, që dallon nga format e metodologjive tjera në kuptim, meditim, referencë dhe perceptimin e informatave, gjithashtu në praktikën shoqërore që vjen si rezultat i kësaj. Kemi si qëllim selefizmin e themeluar mbi Kuran dhe Sunet, ku ka mjaft hapësirë për reforma dhe ixhtihad. Nuk është morali i selefizmit rrënimi i të tjerëve për t'u dukur dhe për t'u bërë i madh ti, përkundrazi duhet të mbushësh atë zbrazëti shkencore apo praktike në mejdanin islam sot.

Ai selefizëm që nuk ka si sjellje shpresën që të tjerët të gabojnë për t'u hipur në qafë atyre, selefizëm i cili ka burra të edukuar që nuk shpërfillin të metat e zemrës, por i japin rëndësi përmirësimit të brendshmes para të jashtmes, largohen nga mendjemadhësia, zilia dhe urrejtja. Njerëz të Zotit, që ngjallin neveritjen për realitetin e keq, që po përjeton



“...Nëse një dijetar apo hoxhë gabon, a na lejon neve kjo situatë që të braktisim kuptimin e drejtë të selefizmit...”

Umeti, jetë ku nuk qortohet e keqja, as e mira nuk përhapet dhe pastaj mbjellin tek njerëzit shpresën për reforma. Nuk po flasim për selefizmin si ndonjë xhemat i caktuar (apo disa xhemate), apo si ndonjë metodologji konkrete, pasi ai është një metodologji dhe referencë e vetme: Kurani, Suneti dhe gjeneratat më të mira përpara se të derdhej ai lumë nëpër degë të tjera aty-këtu, që

gjithmonë largohen nga shtrati i sigurt. Si ka mundësi të ndërtohet një metodologji, ide, shtet apo shoqatë pa TEKST, që në fakt i themelon (ndërton) të gjitha këto grupime?

Nëse kthehemi nga e para dhe pyesim: Si do të ishte gjendja pas largimit nga Feja të shumë fiseve arabe pas vdekjes së Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, si do të ishte gjendja e Gadishullit Arabik sikur të mos ishte suksesi i Allahut të Lartësuar, që ia dha Ebu Bekrit të mbështetet në TEKST që në fakt, me të udhëhoqi luftërat kundër renegatëve. Si do të ishte gjendja e Ehli Sunetit gjatë sprovës rreth krijimit të Kuranit, sikur të mos ishte TEKSTI, i cili në fakt qe shtytësi për Ahmed ibën Hanbelin.

Nëse një dijetar apo hoxhë gabon, a na lejon neve kjo situatë që të braktisim kuptimin e drejtë të selefizmit, i cili është poli pozitiv përballë kulturave të varësisë dhe ideve të injorancës. Ai është poli pozitiv përballë besëtytnive dhe mashtrimeve që dehin logjikën dhe pastaj e dërgojnë në fund të pusit. Ai është poli pozitiv që liron trurin e muslimanit nga litari i zakoneve, pushteti i traditave, si dhe e shpëton nga prapambetja duke e kthyer te themelet mbi të cilat u ndërtua Islami.

Ku mbërritën ata që braktisën këtë metodologji, ata të cilët nuk kanë parime e as TEKSTE? Ata u bënë një me armiq të Islamit dhe heshtën për padrejtësinë dhe çrregullimin, u bënë pre e dyfytirëshave në çdo vend dhe në gjithë këto ata ende mendojnë se po bëjnë shumë mirë dhe se janë në pedestalin më të lartë të politikës.

T'i përmbahemi kuptimit të vërtetë të selefizmit mjafton për të pasur moralin e bukur dhe të kemi shëmbëlltyra të larta,

“Islami është dogmë, që nënkupton përkatësi dhe është entitet kulturor, që është ndërtuar me vite. Ai është peshore dhe jo i peshuar...”

“Nuk quhet popull normal ai që braktisë rrënjët e veta për t'u shndërruar në “bashkëkohor...”

mjafton për t'i ruajtur parimet që pengojnë rrëshqitjen e teposhtave që nuk ua dimë fundin.

Kuptimi i vërtetë i Ehli Sunetit bëri që Ibën Tejmija të përfaqësojë arsenalin e projektit për Rilindjen Islame Bashkëkohore, sepse të tjerët që shtjelluan temën e Rilindjes dhe shkruan për të e që njihen si rryma reformiste nuk ia mësynë thelbit të mendimit islam, prandaj përpjekjet e tyre qenë fabrikim dhe një lloj disfatizmi përballë sulmit kulturor perëndimor kundër Islamit. Kështu që, një “intelektual” i tillë kur mbetet midis ose-ose d.m.th. “ose” bashkëkohore apo “ose” origjinale, “ose” logjika, “ose” besëtytnia, ne e vërejmë se rënia në kësi kontradiktash është qartësisht një besëtytni në vete.

Nuk quhet popull normal ai që braktisë rrënjët e veta për t'u shndërruar në “bashkëkohor”. Amerika e cila u rrit me një kontinent të ri erdhi nga Evropa duke bartur me vete kulturën protestante, ndërsa ne humbasim energji të shtrenjta në debate shterpe, që supozojnë kundërshtinë e këtyre diodave.

Islami është dogmë, që nënkupton përkatësi dhe është entitet kulturor, që është ndërtuar me vite. Ai është peshore dhe jo i peshuar. Nga ky entitet nuk lejohet devijimi, sepse ashtu humbasim identitetin tonë, madje nuk lejohet të devijojmë as nga një pjesë e tij (apo disa pjesë të tij), sepse ashtu “rafinojmë” identitetin.

Për të reformuar individin dhe shoqërinë duhet ixhtihad dhe reforma, kurse ata që mendojnë ndryshe nga kjo, ata me të vërtetë janë në gjendje të luhatshme. ■

Nga arabishtja: Omer B.

ORA E MEKËS TESTOHET GJATË MUAJIT RAMAZAN

Arabia Saudite ka filluar me testimin e orës më të madhe në botë, që gjendet në qytetin e shenjtë të Mekës gjatë këtij muaji të agjërimit, raportojnë agjencitë zyrtare të lajmeve. Kulla e orës do të jetë i dyti rrokaqiell më i lartë në botë me një lartësi prej 600m kur të përfundohet. Kompleksi i famshëm gjendet përballë Xhamisë së Madhe në Meke, e cila vizitohet nga miliona haxhilerë çdo vit.

Vetëm një nga katër anët e orës tanimë është përfunduar dhe është e mbuluar me një mozaik të përbërë prej 98 milion copa qelqi. Në secilën anë do të shënohet “Zoti është më i madhi” në gjuhën arabe dhe do të ketë mijëra drita me ngjyra të ndryshme. Ora do të jetë e dukshme nga largësia 25 kilometra. Një gjysmëhënë e artë me madhësi 23 metra do të vendosët përmbi orë. Sipas Ministrisë përgjegjëse për këtë ndërtim i tërë projekti do të kushtojë \$800 milion.

XHAMIA E NJU-JORKUT NXIT DEBATE

Në Nju-Jork i është dhënë drita jeshile ndërtimit të një qendre kulturore islame dhe një xhamie. Kjo ka nxitur debate të ashpra, ku janë përfshirë edhe politikanë, nëse duhej të lejohej një gjë e tillë apo jo, pasi xhamia pritet të ndërtohet në afërsi të vendit ku dikur ekzistonin kullat binjake. Objektet gjigante u shkatërruan më 11 shtator 2001, pas sulmit terrorist në Nju-Jork. Kundërshtarët e ndërtimit të kësaj

xhamie thonë se kjo tregon mungesë respekti për viktimat e sulmit terrorist të 11 shtatorit, ndërsa përkrahësit e planit thonë se kjo është thjesht, një e drejtë e shprehjes fetare dhe një e drejtë kushtetuese.

Ky plan ka si qëllim ndërtimin e një qendre kulturore islame në qytetin e Nju-Jorkut, shumë afër vendit ku gjendeshin Kullat Binjake. Kundërshtarët e përdorin si argument faktin se përpos një pishine dhe një qendre arti, pjesë e kësaj qendre, që do të kushtojë 100 milionë dollarë, është edhe ndërtimi i një xhamie. Ish-guvernatorja republikane e Alaskës, Sarah Palin, ka qenë kundërshtarë e zëshme e planit. Ndërkaq përfaqësuesit e Partisë Demokratike kryesisht nuk kanë pranuar të prononcohen. Zyra e senatorit të Nju-Jorkut, Chuck Schumer, bëri të ditur vetëm se nuk e kundërshton planin. Shtëpia e Bardhë në anën tjetër ka qëndruar tërësisht indiferente ndaj këtij debati. Plani ka tejkaluar edhe sfidën e fundit ligjore pasi Komisioni njujorkez për monumentet kulturore nuk e kundërshtoi shkatërrimin e një objekti 152-vjeçar, i cili duhet të rrëzohet për t'i hapur rrugë ndërtimit të qendrës islamike.

MBËSHTETJE DHE PROTESTA PËR QENDRËN MYSLIMANE

Disa qindra mbështetës dhe kundërshtarë të propozimit për ndërtimin e Qendrës muslimane kulturore afër vendit të sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, kanë mbajtur tubime në qendër të Nju Jorkut. Kundërshtarët e këtij propozimi kanë kënduar këngë patriotike dhe kanë

paraqitur fotografitë e sulmeve të dhunshme nga 11 shtatori. Dy rrugë më larg një turmë tjetër kërkonte tolerancë dhe liri të religjionit. Policia kishte vendosur barriera dhe kishte marrë masa parandaluese sigurie. Nuk janë raportuar incidente.

PRIZRENI SHITROI IFTAR PËR SKAMNORËT

Përgjatë 30 ditëve të muajit të shenjtë të Ramazanit komuna e Prizrenit ka ushqyer me Iftar 200 skamnorë, për 50 të tjerë ishte kujdesur shoqata “AKEA”, ndërsa KFOR-i Turk Iftar ka shtruar iftar për 150 persona. Në qytetin e Prizrenit gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit, komuna ka shtruar iftar për 200 persona në gjendje të rëndë ekonomike. Kryetari i komunës Ramadan Muja e ka përkrahur këtë projekt, ndërsa tryeza u shtrua në hotel Therandë, dhe gjatë gjithë muajit të shenjtë iftaret i ka shtruar stafi komunal i komunës së Prizrenit.

TURQIA NË “GUINNESS”, ORGANIZOI IFTARIN MË TË GJATË NË BOTË

Bashkia e Esenlerit ka hyrë në librin e rekordeve “Guinness” pasi ka shtruar iftarin më të gjatë në botë me një gjatësi prej 10 kilometrash të përbërë prej 7 mijë tavolinash. Në iftarin më të madh në botë të shtruar ndonjëherë morën pjesë rreth 41.120 persona. Iftari u shtrua përgjatë rrugës “Atësh-Allanë”. Ushqimi i iftarit u

sigurua një pjesë nga vetë personat e pranishëm, që kishin sjellë ushqim familjar dhe pjesën tjetër të ushqimit e ka siguruar bashkia. Organizatorët kanë siguruar si ushqim sasinë prej 10 tonësh pilaf, 8 ton mish, 100 mijë shishe ujë, 45 mijë shishe me lëng frutash dhe një sasi e madhe dhallë. Personeli i organizatorëve që shërbente përbëhej nga 2 mijë e 900 persona dhe numri i kuzhinierëve ka qenë 50 persona. Në mbrëmjen e iftarit ka qenë i pranishëm edhe kryetari i bashkisë së Stambollit, Kadir Topbash, i cili ka thënë se në këtë iftar të veçantë u vunë në dukje vlerat e larta të miqësisë.

RTV PËR FETVA ZYRTARE

Arabia Saudite është duke shqyrtuar idenë e hapjes së një kanali televiziv dhe radio stacioni zyrtar për dijetarët muslimanë të akredituar për çështje të fetvave ose dekreteve fetare siç thotë një raport i para pak ditëve. Kanali televiziv do të “krijojë një lidhje të besueshme në mes pyetësve nga brenda ose jashtë Mbretërisë Saudite dhe dijetarë të autorizuar duke komunikuar nga linjat falas për njerëzit nga e gjithë bota, raporton e përditshmja el-Youm. Burimet treguan se kanali do të hapet në kryeqytetin saudit Riad. Kanali do të jetë pjesë e përpjekjeve të kohëve të fundit në Arabinë Saudite për të ndaluar dijetarë të paautorizuar për lëshimin e dekreteve fetare. Më parë këtë muaj, në Arabinë Saudite Mbreti Abdullah lëshoi një dekret që lejon vetëm dijetarë të emëruar zyrtarisht-për të nxjerrë fetva publike, në mbretërinë në shkallë të gjerë të reformave të vendimeve fetare.

RRUGA KRYESORE

Filozofët dhe teoricienët nuk kanë mundësi t'i plotësojnë nevojat shpirtërore dhe logjike të njerëzve, duke dhënë receta për ushqime të shëndosha, duke e përshkruar sjelljen njerëzore, që merr parasysh nevojat për mbrojtjen e mjedisit, apo duke ua mësuar të tjerëve teknologjinë e prodhimit të aeroplanëve modernë...

DR. ABDUL KERIM BEKAR

Edhe qytetërimet sikurse dhe qytetet kanë shenja orientimi dhe monumente referimi. Këto shenja dhe pika drejtimi përdoren nga të huajt dhe të ardhurit për ta gjetur rrugën dhe cakun e tyre në qytetet e mëdha. Shembull i këtyre pikave të orientimit mund të jetë ndonjë monument i njohur ose rruga kryesore në qytetin në fjalë. Pasi ta gjejmë rrugën kryesore vazhdon drejtimi gradualisht që na çon deri të caku.

Nëse kemi të bëjmë me ndonjë njeri i cili nuk i njeh monumentet e qytetit apo nuk i di rrugët kryesore që ndajnë dhe lidhin lagjet e qytetit, atëherë detyra jonë vështirësohet dhe në shumicën e rasteve përfundon pa sukses...

E kështu është edhe gjendja e popujve që e kërkojnë identitetin dhe tiparet kryesore të modelit të tyre civilizues. Gjatë historisë për njohjen e vetvetes, detyrave dhe qëllimeve më të larta janë përdorur dy rrugë: rruga e



shpalljes hyjnore dhe rruga e studimit, hulumtimit dhe të menduarit.

Me ballafaqimin mes kishës në njërën anë dhe dijetarëve e studiuesve nga lëmenjtë e ndryshëm të shkencës në anën tjetër, filozofët u bënë përcaktuesit e opinionit (*opinion maker*). Ata mundoheshin ta përcaktojnë identitetin e qytetërimit me anë të studimit dhe përvojës historike. U munduan ta kuptojnë natyrën e gjërave, ligjet dhe rregullat që ndikojnë në rrjedhjen e jetës. Roli i fesë u marginalizua deri në skajshmëri.

Në këtë realitet problemi me të cilin u ballafaquan filozofët ishte paaftësia e logjikës me të gjitha dimensionet e saj në zbulimin e rrugës kryesore, në vendosjen e kornizave kryesore, në instalimin e referencave, që do të tejkalonin problemet e mendimeve individuale dhe mospajtimeve. Në këtë shoqëri prijësit e mendimit dhe të analizës u ngjajnë drejtuesve të taksive, që i njohin me hollësi rrugicat dhe sokakët e mëhallëve në të cilat punon, ndërsa nuk e di rrugën që të çon në aeroport, apo rrugët kryesore që e ndajnë qytetin në pjesët e tij veriore, jugore, lindore e perëndimore. Ky shofer mundet të fitojë furnizimin e tij në rajonin të cilin ai e njeh në imtësitë më të vogla...

Filozofët dhe teoricienët nuk kanë mundësi t'i plotësojnë nevojat shpirtërore dhe logjike të njerëzve, duke dhënë receta për ushqime të shëndosha, duke e përshkruar sjelljen njerëzore, që merr parasysh nevojat për mbrojtjen e mjedisit, apo duke ua mësuat të tjerëve teknologjinë e prodhimit të aeroplanëve modernë... duke e pasur parasysh këtë, si dhe duke lexuar shumë autorë perëndimorë unë e shoh se ata kanë iniciuar një lëvizje të gjerë, por brenda një shpelle të vogël dhe të errët. Në orvatjet e tyre ata shpeshherë më duken si një dallëndyshe, e cila mundohet të gjejë rrugën për të ikur nga kafazi i saj. Kjo ngase njeriu ka

aspirata të vrullshme për ta njohur realitetin me të cilin do të ballafaqohet pas vdekjes, por logjika e tij nuk është e aftë që të arrijë tek ato njohuri pa udhëzimin e jashtëm.

Rëndësia e kësaj që thashë ndoshta nuk do të ishte e madhe po të mos vërenim teorizimet e shumta, që prezantojnë vizionet perëndimore rreth së vërtetës, obligimeve, lumturisë dhe hidhërimit. Si rezultat ishte shkaktimi i konfuzionit gjatë përcaktimit të kushteve esenciale për përparim dhe prosperitet.

Pa e zgatur shumë do të mundohem të sqaroj tiparet kryesore të identitetit tonë civilizues, me shpresë që t'i ruajmë dhe të mos lejojmë anashkalimin e tyre gjatë vetënjohjes dhe gjatë projektimit në të ardhmen. Mendoj se tiparet kryesore janë:

1. Faktet e prera - gjëra nga feja që duhet të dihen domosdoshmërisht. Shembuj janë: besimi në Allahun, në librat e shpallura, në të dërguarit e Zotit, në Ditën e Gjykimit, në engjëjt e Allahut dhe në caktimin-kaderin, pesë kushtet e Islamit, njohja e mëkateve të mëdha si shirku, vrasja, zinaja, pirja e alkoolit, vjedhja, kamata...

Këto të vërteta të përgjithshme për muslimanin janë kornizat e vizionit, mendimit, hulumtimit dhe gjykimit. Mospranimi i tyre, ose e disave prej tyre janë shumëfish më të dëmshme se sa mosnjohja e rrugës kryesore nga shoferi i taksisë në qytetin ku punon.

2. Prioriteti i ndërtimit logjik dhe shpirtëror përpara ndërtimit urban. Fisnikërimi i logjikës, pastrimi i shpirtit dhe rrënjëzimi i parimeve etike dhe morale kanë rëndësi më të madhe, se sa ndërtimi i infrastrukturës që siguron një jetë më të lehtë nga aspekti material. Përparimi i vërtetë në vizionet qytetëruese lidhet parimisht me përparimin shpirtëror dhe moral. Ky lloj zhvillimi dhe përparimi ishte kryesor tek gjithë të Dërguarit e Allahut,

“...Fisnikërimi i logjikës, pastrimi i shpirtit dhe rrënjëzimi i parimeve etike dhe morale kanë rëndësi më të madhe, se sa ndërtimi i infrastrukturës që siguron një jetë më të lehtë...”

alejhimu selam, fakt ky të cilin e vërtetojnë shumë tekste të shpalljes hyjnore (Kurani dhe Suneti). Mbi 99% prej ajeteve kuranore flasin për ndërtimin shpirtëror, logjik dhe moral të njeriut.

3. Gjithë arritjet civilizuese dhe sukseset infrastrukturore, si dhe gjithë zbulimet në sferat e ndryshme të jetës nga pikëpamja e vizionit qytetëruese janë vetëm mjete. Nga ne kërkohet që të përdorim për të arritur tek qëllimi më i lartë në këtë botë kalimtare. Ky qëllim është zbatimi i urdhrit të Allahut në formën më të mirë të mundshme, me shpresën që do të jemi ata fitimtarë, të cilët do t'i kaplojë mëshira e Allahut. Me njohjen e këtij qëllimi e mbrojmë veten nga thellimi në imtësi, si dhe nga humbja në labirintet e interesave që ndeshen, mospajtimeve rreth parimeve të përdorimit të forcës dhe angazhimit të forcave që kemi.

Zgjedhja e kësaj rruge nuk analizohet nga aspekti i lehtësisë apo shpejtësisë së lëvizjes dhe arritjes. Më rëndësi është pika drejt në të cilën na çon kjo rrugë, sepse me humbjen e qëllimit më të lartë shumë nga angazhimet e njerëzimit dhe vuajtjet gjatë realizimit të arritjeve do të humbin kuptimin, që në esencë është edhe humbje e vetvetes. ■

Përktheu: Talha Kurtishi



JAM I KËNAQUR ME MUHAMEDIN SI I DËRGUAR

Si mund ta realizojë të kënaqurit me Muhamedin si i dërguar ai që lë atë me të cilën ai ka ardhur për fjalët e dikujt tjetër dhe që nuk i lë fjalët e të tjerëve për shkak të fjalëve të tij; që nuk argumentohet me fjalët e tij përveçse atëherë kur përshtatet me medhhebin e tij, e nëse e kundërshton atë nuk ia hedh sytë fjalës së tij

PROF. DR. NASIR EL OMER

Të jesh i kënaqur me Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem* si i dërguar është nga kërkesat e saktësimit të besimit. Kështu saktësohet besimi i robit, i cili patjetër duhet të dorëzohet dhe të pranojë se Muhamedi i biri i Abdullahut, i biri i Abdulmutalibit, i biri i Hashimit nga fisi Kurejsh është i dërguar nga Allahu me shpallje tek njerëzit dhe xhinët, të jetë i kënaqur dhe të mjaftohet me këtë, të ndihet

i qetë e të tregojë nderim për të, të mos tregojë pakënaqësi, keqardhje apo zemërim për këtë.

Ky është kuptimi i kënaqësisë, kuptimi i profetësisë. Pra, të jesh i kënaqur me Muhamedin si i dërguar. Ibën Rexhebi Allahu e mëshiroftë ka thënë: "Të jesh i kënaqur me Muhamedin si i dërguar, kërkon të jesh i kënaqur me të gjithë atë që ai ka ardhur, të dorëzohesh ndaj saj dhe ta pranosh me kënaqësi. ***"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë,***

derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht”^{1,2}

Ibën Kajimi ka thënë: “Si mund të realizohet kënaqësia me Muhamedin si i dërguar, nëse nuk merret si gjykues për të brendshmen dhe të jashtmen, t’i marrë bazat dhe degët e fesë vetëm nga kandili i tij. Si mund ta realizojë të kënaqurit me Muhamedin si i dërguar ai që lë atë me të cilën ai ka ardhur për fjalët e dikujt tjetër dhe që nuk i lë fjalët e të tjerëve për shkak të fjalëve të tij; që nuk argumentohet me fjalët e tij përveçse atëherë kur përshtatet me medhhebin e tij, e nëse e kundërshton atë nuk ia hedh sytë fjalës së tij. Qëllimi i kësaj është, se është nga e drejta e Allahut ndaj robërve të Tij, që të kënaqen me Të si Zot, me Islamin si fe dhe Muhamedin si të dërguar”.³

Nga sa thamë kuptojmë rëndësinë e madhështinë e Sunetit të Profetit, të cilën e kanë lënë pas dore shumë nga muslimanët e ditëve të sotme, ose duke gjetur interpretime për ta shmangur atë, ose duke e lënë, ose si shkak i parapritjes së mendimeve dhe dobive imagjinare, aq sa mund të cilësohen ata që kapen pas Sunetit si njerëz ekstremë, të ngurtë e të ngjashme si këto.

Ne jetojmë në një kohë ku kemi nevojë më tepër se kurrë të thërrasim në të (Sunetin e profetit), ta përcjellim dhe të vëmë theksin kohë pas kohe rreth madhërimit të tij dhe librit të Allahut. Kjo për shkak të guximit që kanë treguar njerëzit ndaj tyre në këtë kohë. Guximi ndaj këtyre të dyjave është guxim ndaj fesë. Ju

“...Ai që vë re në guximin e lapsave të tyre kundrejt haditheve të sakta do të sikletoset dhe zemra e tij do të ngushtohet nga dhimbja...”

keni vënë re sesi gazetarë të ndryshëm e të ngjashëm me ta nëpër media sillen me Sunetin në atë mënyrë e cila cenon madhërimin e tij. Nëse ata do ta madhëronin thënësin e tyre, nëse do të sillnin nëpër mend se ato kanë dalë prej gojës së tij *sal-lallahu alejhi ue selem*, do të tregoheshin të kujdesshëm para se ta kundërshtonin e nëse do ta madhëronin thënien e tij nuk do të merrnin guximin e të talleshin, ta anulonin me interpretime të kota e boshe, duke e cilësuar thënësin e tyre –folësin më të mirë të arabishtes-, se është i paqartë apo se nuk din të formulojnë fjalitë.

Ai që vë re në guximin e lapsave të tyre kundrejt haditheve të sakta do të sikletoset dhe zemra e tij do të ngushtohet nga dhimbja. Tashmë çështja e tyre ka evoluar nga lënia dhe braktisja e këtyre haditheve, në shpifje tërthorazi të tyre, madje shpesh herë edhe të qarta. Imam Dhehebiu ka përcjellë nga Ebu Kilabete, se ka thënë: “Nëse i tregon dikujt një hadith dhe ai të thotë: lëre këtë por na sill ndonjë ajet kuranor, dije se ai është i humbur.”

Më pas Imam Dhehebiu shton: Nëse dëgjon mutkeliminët (apologjetët) të thonë: lëre Kuranin dhe hadithet ahad⁴, por përdor logjikën, dije se ai është Ebu Xhehl.

¹ Sure Nisa: 65.

² Xhamiul Ulumi uel Hikem.

³ Shifau el Alil.

⁴ Hadithe Ahad janë të gjitha ato

hadithe të cilat janë përcjellë në mënyrë individuale apo nga një grup i vogël njerëzish, të cilët nuk i plotësojnë kriteret e hadithit

Mutevatir (masiv).

* Këto janë mënyra dhe rrugë nëpërmjet të cilave sufitet përfitojnë fenë e tyre.

Nëse sheh se të pyet ndonjë Sufi e të thotë: Lëri argumentet dhe logjikën, porse përdor shijen dhe dëshirën⁵, atëherë dije se ai është Ibliisi, i cili të është shfaqur me pamje njeriu, ose është futur në të. Nëse ke frikë prej tij atëherë vrapo e ik, ose në të kundërtën luftoje, vendosja gjunjët në gjoks dhe këndoi ajetin kursi derisa ta mbysësh”.⁶

Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* ka porositur të kujdesemi për Sunetin e tij dhe të punojmë me të. Ai ka thënë në hadithin që na e përcjell Irbad ibën Sarije: “*Kapuni pas Sunetit tim dhe Sunetit të prijësve të drejtë pas meje, shtrëngojuni fort pas saj me dhëmballë dhe kini kujdes nga sajaset në fe, sepse çdo sajese është humbje*”.⁷

Allahu i Madhëruar thotë: **“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë, që kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur”**.⁸

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”.

“Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë, ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm”.⁹

“Vallë, a nuk e dinë ata, se për atë që e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij është përgatitur zjarri i Xhehenemit, në të cilin do të qëndrojë përherë?”¹⁰

“...Nëse i tregon dikujt një hadith dhe ai të thotë: lëre këtë por na sill ndonjë ajet kuranor, dije se ai është i humbur...”

“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare”.¹¹

Ibën Kajimi në lidhje me këtë ajet ka thënë: “Allahu u ka tërhequr vërejtjen besimtarëve nga humbja e veprave si shkak i të folurit me Profetin *sal-lallahu alejhi ue selem* me zë të lartë, ashtu sikur flisnin me njëri-tjetrin. Kjo nuk është rride¹² përkundrazi është një gjynah, që të shkatërron punët pa e kuptuar, atëherë ç’mund të thuash për atë që paraprin ndaj fjalës së të Dërguarit *sal-lallahu alejhi ue selem*, udhëzimit dhe rrugës së tij, fjalën, udhëzimin dhe rrugën e dikujt tjetër?!.... A nuk është edhe ky një njeri që e ka shkatërruar veprën e tij pa e kuptuar?”¹³

Thuhet se Ebu Hanife i tha Ibën Ebi Dhibit –imamit të njohur-: “A punon me këtë hadith, o Ebu Harith?” “*Kujt i vritet një i afërm ai ka të drejtë zgjedhje të një prej të dyjave; nëse do merr gjakun e nëse do merr shpagimin*”. Ai më ra në gjoks, i dha një të

⁵ Sijer Alam Nubela: 4/472.

⁶ Ebu Daudi.

⁷ Ahzab: 36.

⁸ Ahzab: 21.

⁹ Nur: 63.

¹⁰ Teube: 63.

¹¹ Huxhurat: 2.

¹² Rride është dezertimi dhe braktisja e fesë.

¹³ Uabulu Sejb: 24.

“Imam Shafiu një ditë na tregoi një hadith dhe unë i thashë: A punon me të? Ai më tha: “A mos po sheh vallë se kam dalë nga kisha apo i veshur si prift, që të them hadithin e Profetit e të mos punoj me të?!...”

bërtitur dhe më tha: “Unë të tregoj hadithin e Profetit ndërsa t’i më thua a punon me të apo jo?!.. Po, punoj me të dhe ajo është detyrë për mua dhe për atë që e dëgjon. Vërtet Allahu zgjodhi Muhamedin prej njerëzve dhe i udhëzoi ata me të dhe në duart e tij, dhe atyre u zgjodhi atë që zgjodhi dhe për të, kështu që krijesat duhet ta pasojnë atë të bindur dhe ata nuk kanë si të veprojnë ndryshe.” Dhe ai vazhdoi kështu derisa thashë: Ah sikur të heshte.

Humejdi ka thënë: Imam Shafiu një ditë na tregoi një hadith dhe unë i thashë: A punon me të? Ai më tha: “A mos po sheh vallë se kam dalë nga kisha apo i veshur si prift, që të them hadithin e Profetit e të mos punoj me të?!...”

Shafiu u pyet për një çështje dhe tha: Është përcjellë për këtë nga profeti ky dhe ky hadith. Pyetësi i tha: O Ebu Abdullah! A punon ti me këto hadithe?- Shafiu u nevrikos e kundërshtoi dhe më pas i tha: Cila është ajo tokë që më mban mua dhe cili është ai qiell që më mbulon, nëse përcjell prej Profetit ndonjë hadith me të cilin unë nuk punoj?

Imam Ahmed bin Hanbeli ka thënë:

“Kush e refuzon hadithin e Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk ka dyshim se është në buzë të humnerës.”

Imam Berbehari në librin e tij të akides kur flet për Sunetin ka thënë: “Nëse shikon dikë, që të refuzojë hadithet, apo të flasë keq për to, akuzoje se Islami i tij nuk është i rregullt dhe nuk ka dyshim se ai është bidatçi, apo njeri që pason epshin.”

Ebu Kasim el Esbahani ka thënë: “Ehli suneti prej selefëve kanë thënë: Nëse dikush flet keq për hadithet atëherë akuzoje atë se Islami i tij nuk është i rregullt.”

Qëllimi nga e gjitha kjo është se nuk mund të vërtetohet të kënaqurit me Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem*, si i dërguar nëse Suneti i tij refuzohet dhe nënçmohet. Të kënaqurit me Muhamedin si i dërguar arrihet me madhërimin e Sunetit të tij dhe duke ia njohur vlerën, sikurse e bëmë të qartë nga fjala e Ibën Kajimit më lart.

O ju, që Allahu ju ka nderuar me madhërimin e Sunetit, falënderojeni Allahun për suksesin që u ka dhuruar, sepse selefët duke filluar që nga sahabet falënderonin Allahun për suksesin që u kish dhuruar e që i kish bërë të ecnin nëpër atë me të cilën ishte i kënaqur Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*, sikurse në hadithin e Muadhit, të cilin e dërgoi në Jemen: “Nëse përballesh me një çështje, e cila nuk është në librin e Allahut dhe nuk ka gjykuar për të Profeti dhe nuk kanë gjykuar për të të mirët, çfarë do të bësh?- Tha: Do të bëj përpjekjet maksimale. Profeti tha: *Falënderimi i takon Allahut, që e bëri të dërguarin e Profetit të Allahut, që të gjykojë me atë që e kënaq Profetin e Allahut*”.¹⁴ ■

Përshtati: Bledar Haxhiu

¹⁴ Musanaf Ibën Ebi Shejbe: 7/239.

SIPAS VENDIT BËHET KUVENDI...

Kështu nëse marrim si shqyrtim p.sh mbitheksimin në çështjet e bidatit dhe lënien pas dore të promovimit të Sunetit, padyshim që kjo metodologji prodhon muslimanë, të cilët e shohin si prioritet vetëm mbrojtjen e fesë nga risitë dhe lënë kështu për rrjedhojë të mangët zbatimin e detyrimeve apo veprave të pëlqyera që promovojnë Sunetin

SHKRUAN: JUSTINIAN TOPULLI

Cdo gjë në kohën, në vendin dhe në masën e vet. Është ky një parim madhor, që nëse do ta perifrasonim në një fjalë të vetme do të themi se është vetë Urtësia. Ky atribut hyjnor, ndoshta nuk mund të shpjegohet më mirë dhe më qartë sesa me fjalinë e mësipërme. Vetëm Allahu është Ai, që për shkak të dijes së Tij gjithëpërfshirëse, është në gjendje të vendos çdo gjë në kohën, në vendin dhe në masën e duhur, për këtë dhe vetëm Ai e meriton në përsosmëri absolute emrin i Urti. Çdo njeriu që i dhurohet një pjesë e kësaj cilësie, aq sa ai të quhet mes njerëzve si njeri i urtë dhe i mençur, padyshim që i është dhuruar një mirësi e madhe. Allahu thotë: ***“Ai ia jep urtësinë kujt të dojë. Kujtdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetër kush, përveç njerëzve të mençur.”*** (2:269)

Nëse i bëjmë një zbërthim më të imët përkufizimit të mësipërm, do të vëmë re se çdo punë mes tyre edhe ajo më e lëvduara, thirrja e njerëzve në fenë e Zotit, që të jetë e suksesshme dhe e pranuar duhet të bazohet te tre elementë: koha, vendi dhe masa. Dy të parat kanë të bëjnë më shumë me njohjen e realitetit përkatës, ku do të predikohet fjala e

Allahut, ndërsa e treta ka të bëjë më shumë me vetë lëndën e ligjërimit fetar. Kështu që e shpjeguar më thjeshtë kjo do të thotë, se një thirrës musliman duhet të njohë realitetin specifik, ku ai ushtron ligjërimin e tij dhe në këtë realitet ai duhet të shkarkojë materialin e tij fetar, me masën që kërkon ky realitet dhe në bazë të rëndësisë dhe përparësisë që ka ky material fetar për vetë fenë. Pra procesi i një ligjërimit të urtë kontrollohet nga një fre i unifikuar me dy skaje: kuptimi i realitetit dhe kuptimi i fesë. Njohja e realitetit kërkon njohjen e kohës dhe vendit, ndërsa njohja e masës, kërkon kuptimin e saktë të fesë. Të dyja këto anë kanë ligjet e veta të përcaktuara nga Zoti. Realiteti zhvillohet sipas ligjeve natyrale që ka përcaktuar i Gjithëfuqishmi, po kështu edhe feja është e ndërtuar sipas ligjeve fetare që ka përcaktuar i Gjithëdijsmi. Duke qenë se burimi është i njëjtë, roli i një thirrësi është jo të krijojë përplasje ndërmjet këtyre dy ligjeve, por të dijë të zbatojë ligjet fetare të Zotit në realitetin e ligjeve natyrale. Është absolutisht e pamundur që ligjet e urdhëruara të Allahut të thyejnë ligjet natyrore të Tij, tentativa për thyerje ndodh pikërisht për shkak të mosnjohjes së njërës apo të tjetrës. Dhe duke qenë se asnjëra teorikisht nuk pranon thyerje, në praktikë një mosvendosje e drejtë e tyre do të thotë shtrembërim i njërës. Në rastin tonë ligjet fetare janë ato që pësojnë deformime, pasi ligjet natyrore të Zotit janë të paepshme dhe në rrjedhjen e tyre njeriu e ka të pamundur të ndërhyjë. Kështu pra realiteti është toka dhe feja është plugu, ndërsa ti o njeri je ai që do të mbjellësh dhe do të korrësh nga kjo tokë dhe me këtë plug.

Nëse i bëhet një vështrim i detajuar argumenteve fetare dhe historisë profetike do të vihet re, se krahas luftës dhe mohimit që i bëhet të keqes me të gjitha ngjyrimet e saj, njëkohësisht promovohet edhe e mira me të gjitha format e saj të mundshme. Madje nuk e

“...Lufta ndaj së keqes nuk është qëllim në vetvete, por mjet i rëndësishëm për vendosjen e së mirës...”

teprojmë nëse themi, se në shumë raste peshorja anon pikërisht nga ana e cila promovon të mirën, të bukurën dhe sublimen, sepse lufta ndaj së keqes nuk bëhet vetëm duke e shfarosur atë, por edhe duke e zëvendësuar atë me alternativën e kundërt të saj. Por nëse një luftë goditëse ndaj së keqes e jep rezultatin shumë më shpejt, promovimi i së mirës për të zënë vend në zemrat dhe në praktikën e njerëzve kërkon një kohë më të gjatë, dhe pikërisht për këtë arsye intensiteti i promovimit të së mirës në sasi dhe në kohë duhet të jetë më i madh. Në fund të fundit edhe qëllimi final dhe më madhor i fesë është pikërisht ai i promovimit të së mirës. E keqja luftohet, pikërisht sepse ajo i zë vendin së mirës dhe bëhet pengesë për përhapjen e saj. Pra, lufta ndaj së keqes nuk është qëllim në vetvete, por mjet i rëndësishëm për vendosjen e së mirës. Duke qenë se e mira është qëllim në vetvete, atëherë është e natyrshme që ajo të mbizotërojë si në kohë dhe në sasi, në ligjërimit islam.

Kështu nëse marrim si shqyrtim p.sh mbitheksimin në çështjet e bidatit dhe lënien pas dore të promovimit të Sunetit, padyshim që kjo metodologji prodhon muslimanë, të cilët e shohin si prioritet vetëm mbrojtjen e fesë nga risitë dhe lënë kështu për rrjedhojë të mangët zbatimin e detyrimeve apo veprave të pëlqyera që promovojnë Sunetin dhe që në tekstet e shenjta ai zë pjesën më të madhe të fesë.

Nëse një pjesë e madhe e ligjërimit islam përqendrohet tek lufta ndaj bidatit dhe risive në fe, detyrimisht tek vetë ligjëruesi, por për më tepër tek dëgjuesi do të prodhohet ndjesia se çështjet më madhore të fesë bazohen te

lufta ndaj bidatit dhe risive. Ndërkohë që intensiteti me të cilin duhen trajtuar çështjet e fesë, ka të bëjë me dy elementë kryesorë: me masën apo intensitetin me të cilin ato janë trajtuar në Islam dhe me realitetin përkatës ku lëvrohet ky intensitet.

Për ta kuptuar le të japim një shembull: Kurani i mëshon shumë çështjes së shirkut, çka tregon se shirku është një fenomen që duhet luftuar fort, por më shumë se kaq ai i mëshon çështjes së adhurimit, pasi predikimi i adhurimit të një Zoti të vetëm është vetvetiu edhe luftë e hapur ndaj shirkut, gjëra që absolutisht nuk mund të ndahen. Shirku dhe praktikatat e tij luftohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndaj dhe nuancat që merr kjo luftë janë të kufizuara, ndërsa adhurimi i Allahut urdhërohet dhe nxitet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, për këtë dhe ngjyrimet dhe format janë më të larmishme. Kështu Kurani na tregon për Allahun, atributet dhe emrat e Tij, për plotfuqishmërinë e Tij, për krijimin e Tij madhështor, për mënyrën sesi ai duhet adhuruar, për shpërblimin e atyre që e adhurojnë dhe ndëshkimin e atyre që nuk e adhurojnë... të gjitha këto njëkohësisht nxisin adhurimin e Allahut dhe luftojnë shirkun.

Ndërsa nëse e shohim Kuranin në realitetin e kohës dhe vendit ku ai zbriti, do të kuptojmë shumë më mirë dhe më qartë se pse në Kuran gjejmë një intensitet të tillë ligjërimi kundrejt shirkut dhe formave, me të cilat ai praktikohej nga arabët në atë kohë. Krahas kësaj do të gjejmë edhe shembuj historikë të popujve më të hershëm, ku në thelb edhe aty të bie në sy lufta ndaj shirkut dhe urdhërimi për adhurimin e Allahut, por dallimi mes këtyre shembujve dhe atyre që kishin të bënin me arabët ka të bëjë me realitetin e gjithsecilit. Nëse p.sh. arabët nuk kishin pasur më parë Profet dhe ishin të zhytur në forma të shumta, nga më absurde dhe primitive të shirkut, ligjërimi kuranor i

“Leximi i librave që përmbledhin thëniet e dijetarëve për çështjet e bidatit, pa njohur më parë rregullat teorike, si dhe rrethanat e kohës dhe vendit ku ato janë thënë rrezikojnë të prodhojnë imitime të shëmtuara...”

përgjigjet këtij realiteti, ndërsa nëse hebrenjtë ishin një popull njohës i fesë, që kishin pasur Profetë të shumtë dhe shirku tek ta shfaqej në forma më të stërholluara dhe krahas saj tek ata shfaqeshin edhe probleme të tjera me fenë, Kurani i përgjigjet këtij realiteti me ligjërimin përkatës, që ndryshon nga ai i mëparshëm drejtuar arabëve. Nëse arabët, idhujtarë naivë, të zhytur në adhurimin e qindra statujave, gurëve, drurëve, njerëzve dhe xhinëve paraqisnin si emergjencë një mbitheksim dhe intensitet të lartë të luftës ndaj shirkut, dhe njohjes së madhështisë së Allahut, tek hebrenjtë ndryshonte situata. Hebrenjtë kishin më së shumti probleme me egon e tepruar nacionaliste, me dhënien pas jetës së kësaj bote, me risitë, keqinterpretimet dhe devijimet që ata vazhdimisht fusnin në fenë e tyre dhe për këtë shkak shirku tek ta ishte më i kamufluar, pikërisht dhe ligjërimi kuranor karshi hebrenjve e vendos theksin mbi këto probleme dhe ka trajtën e një ligjërimi rikujtues, riparues dhe ndreqës të asaj çka qe prishur dhe dëmtuar tek ta dhe që ishte pikërisht ndjeshmëria fetare. Nëse arabët kërkonin një ligjërim në trajtën e një argumentimi dërmues ndaj injorancës së tyre, hebrenjtë kërkonin një ligjërim prekës, një ligjërim që t'u kujtonte atyre mirësitë e Zotit dhe historinë e të parëve të tyre në

“Pas nesh do të vijnë njerëz që do ta lexojnë Kuranin dhe nuk e dinë se për kë dhe kur ka zbritur, do t'i marrin gjërat me mend, e nëse i marrin me mend do të përçahen, e nëse përçahen do të luftojnë mes njeri-tjetrit...”

marrëdhënie me Të, një ligjërime që të zbulonte atë çka mbanin në thellësitë e shpirtit...

Këto shembuj edhe pse të treguar përciptazi tregojnë atë sesi ligjërime dhe argumentet fetare zbresin në masën, kohën dhe vendin përkatës.

Kështu nëse i kthehemi çështjes së bidatit dhe sesi ai trajtohet në Islam, është e domosdoshme që të kuptojmë se çfarë është ai, në sa lloje dhe forma shfaqet, çfarë peshe zë ai në luftën ndaj së keqes që bën Islami, pas kësaj duhet të njohim kohën dhe vendin ku ai shfaqet dhe se çfarë ai cenon konkretisht... etj.

Ashtu siç thamë edhe më sipër, për të kuptuar masën apo intensitetin që kërkon praktikimi i një norme fetare duhet njohur koha dhe vendi sesi ajo është ushtruar apo duhet ushtruar. Kështu nëse do të shohim kohën dhe vendet ku u shkruan shumë nga librat apo u thanë shumë nga fjalët e dijetarëve të hershëm për bidatin do të kuptojmë drejtë rëndësinë e realitetit, si dhe peshën negative që ai përbënte për kohën dhe vendin përkatës.

Në një epokë ku kalifati islam ishte shteti më i fuqishëm i botës, ku aspak nuk vihej në rrezik ekzistenca e Islamit si fe, në një vend ku muslimanëve nuk u rrezikohej identiteti i tyre fetar, por ku famë fitonte çdo asket i

përkushtuar dhe zhurmë bëhej për çdo risi që dilte, në një kohë ku sektarizmi ishte bërë modë e ditës dhe cenonte më së shumti saktësinë e besimin të njerëzve sesa forcën e shtetit, ku Kurani rrezikonte jo të zhdukej e të mos lexohej, por të mos kuptohej si duhet, e Suneti i Profetit të mohohej, në një kohë kur filluan të përhapeshin dokrrat, besëtytnitë dhe përrallat mitike dhe shumëkush mendonte se mund të shiste e të blinte me fenë si t'i donte qejfi... në një kohë të tillë është më se normale të lexosh, se kishte dijetarë që thoshin se dëmi që i sjell një bidatçi Islamit dhe muslimanëve është më i madh sesa dëmi që mund t'i sjellë një i krishterë apo çifut. Leximi i librave që përmbledhin thëniet e dijetarëve për çështjet e bidatit, pa njohur më parë rregullat teorike, si dhe rrethanat e kohës dhe vendit ku ato janë thënë rrezikojnë të prodhojnë imitime të shëmtuara, që dalin jashtë kohës dhe hapësirës ku tentojnë të implementojnë vetveten. Realiteti shqiptar islam nuk bën përjashtim nga kjo gjë.

Është pikërisht mosnjohja e realitetit të atij që shërben si burim frymëzimi dhe të atij në të cilin jetojmë dhe mos dallimi i qartë në mes tyre një nga shkaqet e devijimeve, dështimeve dhe eksperimenteve shterpe me thirrjen islame, e tregon edhe shpjegimi që Ibën Abasi i jep Omerit (radijallahu anhum) për shkaqet e përçarjes dhe përplasjes në mes muslimanëve. Ai thoshte: “Pas nesh do të vijnë njerëz që do ta lexojnë Kuranin dhe nuk e dinë se për kë dhe kur ka zbritur, do t'i marrin gjërat me mend, e nëse i marrin me mend do të përçahen, e nëse përçahen do të luftojnë mes njeri-tjetrit...” E ndërsa pak më parë Ibën Abasi i ishte shprehur Omerit, se ishte pikërisht kjo njohje ajo që i bënte sahabët të mos binin në të tilla gabime.

Dhe historia përsërit vetveten... ■

FEJA ËSHTË KËSHILLË



MUHAMED BESAM JUSUF

Këshilla është t'u bësh mirë njerëzve, t'i udhëzosh ata për tek e mira dhe rrugët e saj, t'i vësh në dukje problemin apo gabimin që gjendet tek ata, apo që i kryejnë, dhe kjo duke vepruar me urtësi dhe këshillë të mirë, në mënyrë që të këshilluarit të punojnë për t'i rregulluar të metat e tyre.

Allahu ka zbritur në Kuranin Famëlartë

fjalët e Nuhit alejhi selam: *“Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe di nga Allahu atë që ju nuk e dini”*. Araf, 62. Po ashtu ka përmendur edhe fjalën e Hudit alejhi selam kur thotë: *“Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim dhe jam këshilltar besnik”*. Araf, 68.

Këshilla... Po përse vallë?!..

Sepse feja jonë e madhe Islame është e ndërtuar mbi këshillën, ashtu sikurse ka

thënë i Dërguari Muhamed *sal-lallahu alejhi ue selem*: “Feja është këshillë”. I thanë: Për kë, o i Dërguari i Allahut? Ai tha: “Për Allahun, për profetin e tij, për librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për të parët e muslimanëve dhe për të gjithë muslimanët mbarë”. Muslimi

Sepse këshilla është njëra ndër themelet bazë të forcës në shoqërinë muslimane, ajo është një nga mënyrat për të larguar problemet dhe për ta pastruar nga boshllëqet dhe gabimet. “Nuk beson askush nga ju përderisa të dojë për vëllanë e vet atë që dëshiron për vete”. Mutefekun alejhi.

Sepse Profeti kur merrte besën e muslimanëve, u merrte atyre besën se do të këshillonin çdo musliman. Xherir bin Abdullahu ka thënë: “I dhashë besën Profetit se do të falja namazin, se do të jepja zekatin dhe se do të këshilloja çdo musliman”. Mutefekun alejhi.

Sepse këshillimi i muslimanëve është rrugë për fitimin e shpërblimit të Allahut dhe se kjo është nga morali i mirë. “Kush fton për në mirësi do të ketë edhe shpërblimin e atyre, të cilët punojnë me të”. Muslimi

Cila është edukata dhe etika në dhënien e këshillës?!...

Butësia, sepse njeriu është i krijuar i atillë që e do atë që sillet mirë dhe e urren atë që sillet keq: “**Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje**”. Ali Imran: 159. Ndërsa Profeti ka thënë: “Vërtet ju jeni dërguar lehtësues e jo vështirësues”. Të gjithë veç Muslimit.

Këshilla të bëhet në mënyrë të fshehtë. Imam Shafiu Allahu e mëshiroftë ka thënë: “Kush të këshillon në publik, ktheja mbrapsht këshillën, sepse ai ka kërkuar injorimin tënd e jo këshillën tënde”. Fudejl

“...Besimtari fsheh dhe këshillon, ndërsa i prishuri turpëron dhe injoron ...”

bin Ijadi Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Besimtari fsheh dhe këshillon, ndërsa i prishuri turpëron dhe injoron”. Sa shumë që janë ata që injorojnë në emër të fesë, apo në emër të këshillës dhe përmirësimit!...

Urrejtja e gjynahut dhe jo e gjynahqarit. Ebu Derda i tha disa personave, të cilët po shanin një burrë: “Mos e shani vëllanë tuaj, dhe falënderojeni Allahun që ju ka ruajtur... Ata thanë: A nuk e urren atë? Ai u përgjigj: “Unë urrej veprën e tij, e nëse e lë atë vepër ai është vëllai im”.

Ndjenja e atij që këshillon se dëshiron sinqerisht udhëzimin e atij që këshillon, si dhe të lutet për udhëzimin e tij. Një herë Profetit i sollën dikë, që kish pirë alkool dhe pasi e dënuan ai po largohej dhe disa njerëz po e mallkonin: O Allah poshtëroje, o Allah mallkoje. Në këtë moment Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* tha: “Mos thoni kështu dhe mos e ndihmoni shejtanin ndaj vëllait tuaj, porse thoni: “O Allah fale atë, o Allah mëshiroje”. Buhari

Të mësojmë se detyra jonë është këshilla në mënyrë të mirë dhe me fjalë të bukura. Sepse ne duhet të kuptojmë që nuk jemi gjykatës për besimin e njerëzve. “**Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër...**”. Huxhurat: 10.

Përshtati: Bledar Haxhiu

TEVESULI DHE AJETI “...DHE KËRKONI EL-VESILEH TEK AI...”

Me këtë provë vërtetuese mësojmë se ajo çka pretendohet prej shumë felëshuesve- pasues të injorantëve pretendues të tesavufit, se gjoja pika kyçe e el-vesileh qenka figura e shehut, i cili shërbeka si ndërmjetës mes tij dhe Zotit të tij, i këtilli është drejtuar në injorancë, verbëri dhe devijim të qartë

MUHAMMED IBËN SALIH EL MUNEXHID

(Përkthimet e kuptimit të ajetit kuranor (sure Maide: 35) “...dhe kërkoni el-vesileh tek Ai;...” për të cilin bën fjalë kjo temë, të marra nga tre përkthyesit kryesorë të kuptimeve të ajeteve kuranore në gjuhën shqipe, janë të sakta dhe përkojnë mu me komentin që ka sjellë Ibën Kethiri, e të tjerë nga komentuesit e gjeneratave të arta, siç do të vëreni në shtjellimin shkencor të kësaj tematike që bën autori! Duke përqasur përkthimet do

të vëreni lehtë njëzëshmërinë e përkthyesve rreth kësaj pjese të ajetit:

Përkthimi i Hasan ef. Nahit: “O **besimtarë! Kinie frikë Perëndinë dhe kërkoni el-vasileh te Ai (tentoni që t’i afroheni Atij me vepra të mira), dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar!**”;

Përkthimi i Akademik Feti Mehdiut: “O **besimtarë, frikësohuni All-llahut dhe kërkoni el-vasileh te Ai (përpikuni të jeni të afërt) dhe luftoni për hirë të Tij, që të shpëtoni.**”;

Përkthimi i Sherif Ahmetit, -përkthim ky më i përhapur-: “O ju që besuat! Kinie

frikë All-llahun dhe kërkon el-vasileh te Ai (kërkon afrim te Ai), luftoni në rrugën e Tij që të gjeni shpëtim.”; Sh.p.)

Komenti i shprehjes “el-vesileh” në fjalën e të Lartësuarit: *“O besimtarë! Kinie frikë Allahun dhe kërkon el-vasileh tek Ai, dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar!”* (Kurani, Maide: 35) është rrugë lidhëse për tek Allahu, e për tek Allahu s’ka rrugë tjetër përveç rrugës të cilën e do Ai dhe është i kënaqur me të, e ajo rrugë duhet të jetë me respektimin e Tij dhe të larguarit nga padëgjueshmëria ndaj Tij.

Ibën Kethiri, -rahimehullah-, ka thënë: “Allahu u thotë robërve të Vet duke i urdhëruar që t’ia kenë frikën Atij; Kurse të lidhesh tek Ai me nënshtrim ndaj Tij, konsiston në lënien e ndalesave; Dhe pastaj tha: *“...dhe kërkon el-vasileh tek Ai...”* për këtë ka thënë Sufjan Theuriu, nga Talha, nga Atau, nga Ibën Abasi, -radijallahu anhu-; “(Se el-vasileh) d.m.th. el-kurbah (çka afrohesh me të tek Allahu prej veprave të mira dhe nënshtrueshmërisë; Shih: El-Muëxhem el-Vesit, lënda: kurbah; Sh.p.), dhe kësisoj kanë thënë edhe Muxhahidi, Ebu Vail, Haseni, Katadeh, Abdullah ibën Kethir, Es-Sudij, Ibën Zejd, e të tjerë, dhe Katadeh ka thënë: “D.m.th. afrohuni tek Ai me nënshtrueshmëri ndaj Tij dhe me vepra me të cilat është i kënaqur.” dhe Ibën Zejdi pati lexuar: *“Ata të cilëve u luten këta, vetë kërkojnë mënyrë se si t’i afrohen (el-vesileh) Zotit të vet...”* (Kurani, Isra: 58) dhe kjo është ajo që kanë thënë këta imamë, e për këtë s’ka divergjencë mes komentuesve të Kuranit.

Pra, el-vesail dhe el-vesileh është ajo që: lidhesh për deri tek arritja e objektivit/pikësynimit! (Tefsiru Ibni Kethir, 2/53, 54)

Shejh Muhamed Emin Shenkiti, rahimehullah, ka thënë: “Dije se shumica e

“...Dije se shumica e dijetarëve qëndrojnë në mendimin, se qëllimi këtu me el-vesileh është: afrimi tek Allahu i Lartësuar me nënshtrim ndaj urdhrave të Tij, dhe shmangie nga ndalesat e Tij...”

dijetarëve qëndrojnë në mendimin, se qëllimi këtu me el-vesileh është: afrimi tek Allahu i Lartësuar me nënshtrim ndaj urdhrave të Tij, dhe shmangie nga ndalesat e Tij, në përputhje me atë që ka ardhur Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, me sinqeritet në këtë për hir të Allahut të Lartësuar; sepse kjo është e vetmja rrugë lidhëse për te kënaqësia e Allahut të Lartësuar dhe arritja tek mirësitë e kësaj bote dhe të përtejmes.

Thelbi i el-vesileh është: Rruga që të afron tek diçka dhe lidhesh me të, e ajo -sipas ixhmasë (konsensusit) së dijetarëve- janë veprat e mira. Ngase s’ka rrugë lidhëse (el-vesileh) për tek Allahu i Lartësuar, përveçse me pasimin e të Dërguarit të Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e që për këtë ka shumë ajete të qarta, se cili është qëllimi me rrugë lidhëse, si për shembull fjala e të Lartësuarit: *“...Atë që ua jep Profeti, atë merreni, e atë çka ua ndalon, lëreni!”* (Kurani, El-Hashër: 7) apo fjala e Tij: *“Thuaj: “Nëse e doni Allahun, pasomëni mua!;...”* (Kurani, Ali Imran: 31) apo fjala e Tij: *“Thuaj: “Binduni Allahut dhe të Dërguarit!;...”* (Kur’ani, Ali Imran: 32, En-Nur: 54)

Dhe nga Ibën Abasi, *radijallahu anhum*a, është transmetuar se me el-

vesileh kihet si qëllim *el-haxheh* (nevojë, kërkesë).

Bazuar në këtë fjalë të përcjellë nga Ibën Abasi, kuptimi i “**...dhe kërkon el-vesileh tek Ai!;...**” është: kërkon për nevojën tuaj tek Allahu; sepse Ai është i Vetmi që përcakton për dhënien e saj, dhe ajo që e qartëson këtë pikëpamje është fjala e të Lartësuarit: “**...Ata që po i adhuron ju pos Allahut, nuk kanë pushtet t’ju furnizojnë juve, prandaj, tek Allahu kërkon furnizimin dhe adhuron Atë...**” (Kurani, Ankebut: 17); Dhe fjala e Tij: “**Kërkon prej Allahut nga mirësitë e Tij.**” (Kurani, Nisa: 32); Dhe në hadith: “**Dhe kur të kërkos, kërkoji Allahut!**”.

Shejh Muhamed Emin Shenkitij, *rahimehullah*, më pas thotë: “Të vërtetuarit e domethënies së *el-vesileh* qëndron në atë që kanë konkluduar shumica e dijetarëve, se ajo do të thotë afrim tek Allahu me sinjeritet për Të në adhurim, dhe kjo në përputhje me atë që ka ardhur i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e tefsiri i Ibën Abasit është brenda këtij kuptimi; të lutësh Allahun dhe të kërkos prej Tij për kërkesat dhe nevojat e tua është prej llojeve më madhore të adhurimit, e që kjo është *el-vesileh* për të arritur deri te kënaqësia dhe mëshira e Tij.

Me këtë provë vërtetuese mësojmë se ajo çka pretendohet prej shumë felëshuesve- pasues të injorantëve pretendues të tesavufit, se gjoja pika kyçe e *el-vesileh* qenka figura e shehut, i cili shërbeka si ndërmjetës mes tij dhe Zotit të tij; i këtilli është drejtuar në injorancë, verbëri dhe devijim të qartë dhe të këtillët madje luajnë me Librin e Allahut të Lartësuar. Marrja e ndërmjetësve përveç Allahut është prej bazave të kufrit e të kufarëve, siç e vërteton këtë i Lartësuari me fjalën e Tij ndaj tyre: “**E, ata që marrin përveç Allahut mbrojtës** (thonë): “**Ne i**

lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu” (Kurani, Zumer: 3), dhe fjala e Tij: “**Ata adhurojnë – përveç Allahut – atë që, as nuk u bën dëm, as nuk u sjell dobi dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësit tonë tek Allahu! Thuaj: “A mundeni ju t’i tregoni Allahut se në qiej dhe në Tokë ekziston diçka që nuk e di Ai?!” Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartë qoftë nga ajo që i bëjnë shok Atij!”** (Junus: 18) Kështu që i obligohet çdo besimtari ta dijë se rruga lidhëse për te kënaqësia e Allahut, Xheneti dhe mëshira e Tij është pasimi i të Dërguarit të Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e kush lajthit nga kjo vetëm se ka devijuar nga rruga e drejtë. “**Puna nuk qëndron ashtu, as sipas dëshirës suaj, as sipas dëshirës së ithtarëve të Librit, por është, se kushdo që bën një të keqe, do të ndëshkohet për atë...**” (Nisa: 123).

Gjithashtu këtë domethënie që e shpjeguam e hasim me po këtë kuptim edhe në fjalën e Allahut të Lartësuar: “**Ata të cilëve u luten këta, vetë kërkojnë el-vesileh** (mënyrë se si t’i afrohen) **Zotit të vet**” (Israë: 57), e nuk është si qëllim këtu me *el-vesileh* një vendbanim në Xhenet, për çka na ka urdhëruar i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ta lusim Allahun për të që t’ia japë atij, e ne shpresojmë në Allahun që t’ia japë. E, ajo nuk kërkohet përveçse për një rob, ai shpreson të jetë vetë ai (Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Sh.p.).” (Muhammed Emin Shenkiti, *Edvau el-Bejan*, 2/86-88) ■

Nga arabishtja: Mirsim N. Maliqi

KAM FRIKË!

Padyschim, dashuria duhet të vijë në rend të parë e pastaj shpresa dhe frika. Këto dy të fundit duhet të vijnë menjëherë, edhe pse ndonjëherë shpresa mund të ketë përparësi e ndonjëherë frika. Me rëndësi është se dashuria vjen para tyre

SELMAN EL AUDE

Frika është një ndjenjë e natyrshme dhe Allahu e ka bërë pjesë të pandashme të njeriut dhe të kafsha, në mënyrë që gatishmëria për t'i bërë ballë situatave të rënda të rritet më shumë. Frika gjithashtu i ndihmon ta luftojnë armikun, të ballafaqohen me të, apo së paku të ikë nga ai d.m.th. e mëson të veprojë drejtë përballë rreziqeve që e rrethojnë.

Pse të mos kem frikë, ndërsa frika është instinkt që lindet së bashku me fëmijën, që e edukon të mos bjerë nga shtrati për shembull, të mos bjerë në ujë, apo të mos i afrohet zjarrit që të piqet për së gjalli etj.

Si mund të mos kem frikë, ndërsa Allahu e përmend frikën natyrore për një ndër pejgamberët më të mëdhenj dhe më të dalluar, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të gjithë ata, madje një ndër Ulul Azmit, Musain, alejhi selam.

Ajo që të bie në sy nga historia dhe tregimet e tij në Kuran është se Allahu e përmend frikën e tij në më shumë se një vend. Ai e kishte vrarë një njeri dhe në qytet ndihej i frikësuar dhe priste se çfarë do të ndodhë. Të nesërmen e kuptoi se njerëzit ishin organizuar kundër tij dhe planifikonin ta vrisnin, ashtu që doli nga qyteti i frikësuar dhe priste se ç'do të



ndodhë. Pastaj arriti në Medjen, kreu afatin e caktuar dhe udhëtoi së bashku me familjen e tij. U ndal afër kodrës Tur, dëgjoi thirrjen, e pa zjarrin nga i cili u zmbraps dhe nuk shikonte pas nga frika. Atëherë Allahu i tha:

“Afrohu dhe mos u frikëso!” (Kasas 31).

“O Musa, mos u frikëso sepse tek Unë pejgamberët nuk kanë pse të frikësohen.” (Nemël 10). Pas kësaj, Allahu e porositi atë dhe Harunin të shkojnë te Faraoni dhe Hamani, e Musai tha:

“O Zoti im, unë kam frikë, se do të më quajnë gënjeshtar, e zemra do të më ngushtohet, kurse gjuha mund të më lidhet, dërgoje edhe Harunin.” (Shuara 12-13). Ai së bashku me Harunin thoshin:

“Ata thanë: O Zoti ynë, ne kemi frikë se ai do të na dënojë menjëherë ose do të ndërkrehet më tepër”. Por, Allahu i përkujtoi:

“Tha: Mos kini frikë, Unë jam me ju, dëgjo dhe shoh.” (Shuara 21).

Kështu pra, ne po vërejmë se Allahu na tregon, se si Musa *alejhi selam* frikësohej me këtë frikë të natyrshme instinktive, për të cilën njeriu duhet të lëvdohet dhe jo të shahet e as të qortohet. Madje nga konteksti aludohet se kjo lloj frike e natyrshme pati rezultate të mira.

“Pastaj ika prej jush, kur u frikësova prej jush dhe Zoti im më dhuroi mençuri dhe më bëri një nga të dërguarit.” (Shuara 21).

Pra, njeriu normal frikësohet, sikurse kur i ndjen temperaturat e larta apo të ulëta. Prej instinkteve që gjendet te çdo njeri është instinkti i frikës.

Frika, nëse mbetet brenda kufijve të normales, atëherë është frikë e lëvduar, madje është **mangësi e natyrshme**, pa të cilën njeriu si njeri nuk mund të jetë i plotë. Shembulli i kësaj është sikurse shembulli i shumë gjërave, sikurse gjumi, ngrënia, pirja, martesë etj., gjëra të cilat janë ana tjetër e përkryerjes njerëzore, ku na shfaqet cilësia e Krijuesit, Shpikësit për t'i mposhtur gjërat dhe për t'i përlurur ata.

Gjumi si gjumë është mangësi në vetvete, prandaj Allahu ia ka mohuar Vetes dhe ka thënë:

“Atë nuk e kaplon, as dremetja, as gjumi”. Mirëpo nëse gjejmë një njeri që nuk fle, kjo do të quhej mangësi dhe çrregullim, për të cilin do ta këshillohim ta këshillohet me mjekun dhe të hulumtojë, ilaçin sepse ka mundësi të vdesë.

Atëherë, pse frika është mangësi? Sepse frika vjen si rezultat i dy gjërave apo dy cilësive të njeriu: Cilësia e parë:

Mosdija, sepse njeriu frikësohet nga gjëra që nuk i di dhe nuk i njeh

“...Duhet ditur se frika nuk është emocioni dhe ndjenja më e rëndësishme e njeriut, së cilës i duhet kushtuar rëndësi...”

- prandaj mund të shohësh një tregtar, i cili e ka mësuar një formë dhe një metodë tregtie, madje një prodhim të caktuar, edhe në qoftë ai prodhim diçka shumë i thjeshtë. Nga kjo tregti ai ndoshta mezi nxjerr të paguajë qiranë e dyqanit, mirëpo prapë se prapë ai vazhdon me këtë tregti, sepse gjërat e tjera nuk i njeh, prandaj i paragjykon ato si të pasuksesshme dhe negative.

- gjithashtu edhe një shoqatë, e cila është mësuar që punët e saj t'i bëjë me rutinë, pa hulumtim, pa studim, pa përcaktim të synimeve, nëse shkon dhe u thua se shoqata juaj duhet të ketë një mesazh të qartë, vizion, qëllime të caktuara dhe në varësi prej tyre pastaj i organizon aktivitetet, ata njerëz refuzojnë dhe do të shfaqin frikën, se me këtë formë organizimi do të humbasim gjithçka që kemi pasur më parë.

Kështu ishte gjendja e njerëzve në fillim, ende pa e parë dhe pa e pranuar dritën e mesazhit hyjnor, ata frikësoheshin prej gjërave që i rrethonin dhe kjo ndikoi që më vonë edhe t'i adhuronin. Sikurse ata që adhuruan diellin, dikush hënë, tjetri zjarrin, të tjerët yjet e kështu me radhë. Kjo aludon se tek ata njerëz u krijua një frikë si rezultat i mosdijes, sepse ata nuk e kishin parë dritën e udhëzimit, prandaj edhe i adhuruan gjërat prej të cilave kishin frikë.

Cilësia e dytë: Pamundësia (paaftësia):

Njeriu frikësohet nga gjërat me të cilat

nuk ka mundësi të ballafaqohet apo t'i bëjë rezistencë. Kjo frikë vjen si rezultat i mosdijes dhe i paaftësisë. Frika është gjë e domosdoshme dhe e natyrshme te njeriu. Njeriu është krijuar zullumqar për vetveten dhe i paditur, ai është krijuar i paaftë natyrisht dhe i varfër, prandaj nuk ka mundësi të jetë i panevojë për Allahun as për një çast apo sekondë.

Frika për njeriun mbetet e lëvduar përderisa është brenda kufijve të normales, sepse ajo frikë do ta shpjerë njeriun të punojë dhe të kërkojë përkryerjen. Kështu që frika mbetet si një formë edukimi nga Allahu kundrejt njerëzve, që ata të hulumtojnë pas përkryerjes, qoftë në kërkim të dijes apo duke u munduar ta praktikojnë atë dije. Allahu për Vetveten në suren Shems ka thënë:

“Prandaj, Zoti i tyre i shkatërroi të gjithë për gjynahet e tyre dhe i bëri rrafsh pa pasur frikë prej pasojave të kësaj.” (14, 15)
Çfarë do të thotë ky ajet?

D.m.th. se Allahu nuk frikësohet për pasojat dhe fundin e asaj që ka bërë dhe nuk ka frikë se çfarë mund të shkaktojë ajo te krijesat e tij, sepse të gjitha krijesat janë të Tij. Pra, Allahu i shfarosi ata zullumqarë dhe i shkatërroi, dhe nuk ka frikë për pasojat dhe rezultatet e veprimit të Tij. Kështu ka thënë Ibën Abasi, Hasan Basriu dhe Ibën Kethiri në tefsirin e tij. Allahu ka treguar se banorët e xhenetit nuk do të kenë frikë. Frika për ata mbaroi, meqë ata kanë arritur në fund dhe tani vetëm shpresojnë dhe dashurojnë. Kjo argumenton se frika është mangësi natyrore në këtë botë, sepse gjërat nga të cilat kishin frikë ata, tashmë janë sosur dhe s'kanë prej kujt të frikësohen.

Frika ndaj Allahut është tre llojesh:

Lloji i parë: Frika, e cila nxit në punë të mira dhe dije të dobishme, e çon njeriun nga e mira dhe në gara për të, e ndihmon

“...Kush e adhuron Allahun vetëm me frikë ai është havarixh, kush e adhuron Allahun vetëm me dashuri ai është zindik (i dalë nga feja)...”

njeriun të marrë pjesë dhe të ballafaqohet me vështirësitë, të zgjidhë problemet dhe të pranojë sfidat.

Lloji i dytë: Frika, e cila rritet dhe çon deri në një lloj dëshpërimi dhe këputje të shpresave nga rahmeti i Allahut, apo shkakton që edhe të tjerëve t'ua këpusë shpresat nga ky rahmet. Kjo frikë, pa dyshim se është frikë e qortuar.

Njësoj si kjo është edhe ajo frikë, e cila shkakton dobësimin dhe sëmurjen e njeriut. Këtë e kanë thënë dijetarët qysh më herët dhe kjo është e çuditshme, sepse te shumica e dijetarëve të hershëm frika nuk është numëruar si sëmundje, ndërsa Ebu Hamid Gazaliu e ka theksuar këtë, gjë të cilën sot shkencëtarët e psikologjisë pajtohen njëzëri se frika e tepruar është sëmundje.

Lloji i tretë: Frika e të dobët, e cila nuk është më shumë se një pëshpëritje e shpirtit dhe shkrepje idesh. Gjurmët e kësaj frike nuk duken te gjymtyrët e njeriut, as në veprën e tij, as në sjelljen e tij, ato janë vetëm çaste dhe situata kalimtare në zemër ndonjëherë apo në çastet kur mëkaton, si dhe në çastet kur duhet t'i bindemi Allahut, mirëpo ajo frikë nuk e shtyn t'i bindet Allahut. Kjo nuk quhet frikë e vërtetë, edhe pse thelbi i frikës është i pranishëm tek ai njeri. Disa dijetarë kanë thënë:

Në çdo besimtar ka një sasi frike, por ajo mund të jetë më shumë ose më pak.

Varësisht nga kjo frika është tre shkallë:

- shkalla e mesme,
- shkalla ekstreme, dhe
- shkalla e dobët.

Frikë mesatare është të mos e teprojë e as cunjojë, siç përmendëm më herët. Frikë mesatare është të mos ndërkrehet ndaj të tjerëve me ndjenjat dhe emocionet e tij, segment ky i rëndësishëm dhe i lartë në edukim.

Duhet ditur se frika nuk është emocioni dhe ndjenja më e rëndësishme e njeriut, së cilës i duhet kushtuar rëndësi, prandaj një dijetar ka thënë: “Kush e adhuron Allahun vetëm me frikë ai është havarixh...”, sepse tek ata frika është më e theksuar, ndaj e tepruan në adhurime, u hipën mbi kokë njerëzve dhe shpikën fitnen e parë dhe më të madhen në historinë islame. Për asnjë grupacion të bidatçive nuk ka kërcënime pejgamberike të vërtetuara, sikurse kërcënimet e vërtetuara për havarixhët, madje shumë nga ato hadithe gjenden në të Dy Sahihët. Duhet ditur se thelbi i kësaj sëmundjeje dhe shtrembërimi është teprimi në frikë.

Është thënë: “Kush e adhuron Allahun vetëm me frikë ai është havarixh, kush e adhuron Allahun vetëm me dashuri ai është zindik (i dalë nga feja)...”. Shumë sufinj e kanë tepruar duke kënduar për dashurinë ndaj Allahut, ndërsa e shlyen segmentin e frikës dhe të shpresës, kështu që fjalja vazhdon: “...kush e adhuron Allahun vetëm me shpresë ai është murxhi, ndërsa kush e adhuron Allahun me dashuri, frikë dhe shpresë ai është besimtar muvehid”.

Besimtari më i plotësuar është ai që ka arritur të barazojë frikën dhe shpresën. Ibën Kajimi thotë: Zemra është sikurse shpendi: dashuria si koka e tij, ndërsa shpresa dhe frika si krahët e tij. Cila është më e rëndësishme pra? Koka apo krahët? Normalisht që koka, sepse sikur t'i hiqej

koka shpendi do të ngordhte, a sikur t'i këputeshin krahët shpendit nuk do të ngordhte, mirëpo do të mbetej në rrezik dhe në mundësi për secilin që dëshiron ta kapë apo ta therë.

Padyshim, dashuria duhet të vijë në rend të parë e pastaj shpresa dhe frika. Këto dy të fundit duhet të vijnë menjëherë, edhe pse ndonjëherë shpresa mund të ketë përparësi e ndonjëherë frika. Me rëndësi është se dashuria vjen para tyre. Personalitetin e njeriut ndonjëherë e ngjasoj me vaktin e bukës. P.sh. një njeri dëshiron të përgatisë groshë, atij i duhet një sasi groshë, një sasi ujë, një sasi kripë, një sasi vaj, mëlmesa etj. Të gjitha këto duhet të vendosen me kujdes dhe sasi të caktuara, por nëse i hedh ato në mënyrë jo proporcionale, a thua vallë çfarë do të ndodhë?

Ushqimi do të priset, ndoshta tërësisht, ndoshta pjesërisht. Nëse e shijon atë do ta vëresh sa ka shumë kripë, ose do ta shohësh se nuk hahet, ose... ose. Pastaj edhe zierja e atij ushqimi nëse teprohet apo shkurtohet do të dali pa shije ose do të digjet fare. Kështu është edhe personaliteti i njeriut, të gjitha ndjenjat dhe emocionet e tij duhet të jenë të përafërta dhe të përziera. Prandaj disa njerëzve të cilët vazhdimisht pyesin: Filan filani apo filan grupi kanë devijuar apo nuk kanë devijuar? Ne mund tu themi:

Nëse thelbi i tyre në përgjithësi është i shëndoshë, atëherë mbetet si i tillë dhe nuk mund të thuash: se ai njeri apo ai grup ka devijuar në thelb. Mirëpo mund t'i thuash se ata i kanë shtuar ushqimit disa gjëra dhe disa të tjera i kanë anash, prandaj ushqimi i tyre nuk është i shijshëm dhe i shëndoshë. E ka tepruar me frikë, apo me shpresë apo me ndonjë çështje tjetër, apo ka bërë një lloj këmbëngulje në diçka të caktuar, kjo doemos do të reflektohet mbi rezultatet e asaj çfarë do të dalë nga ky gatim apo nga ky edukim.

Këtë që po e themi se frika dhe shpresa duhet të jenë të barabarta, ndërsa dashuria përpara, fillimisht e themi për frikën ndaj Allahut, e cila mund të jetë frikë nga Ai apo frikë nga gjynahet që i bëjmë ndaj Tij. Cila frikë është më e mirë dhe më e lartë?

Frika nga Allahu; sepse mund të ketë ndonjë njeri që nuk bën mëkate të mëdha, mirëpo frika nga Allahu gjendet në zemrën e tij. Padyshim se frika nga Allahu është më madhështore se frika e njeriut nga mëkatet që i bën. Allahu na tregon se kështu bënë edhe pejgamberët:

“...i luten Zotit të tyre me frikë dhe shpresë.” (Sexhde 16)

Të përmendim tregimin e shënuar në hadithet e vërteta nga Ribij ibën Harashi, i cili përcjell se Ukbeja i kishte thënë Hudhejfes: A nuk po na rrëfen çfarë ke dëgjuar nga Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem?* Ai tha: E kam dëgjuar duke thënë: *“Një njeriu i ishte afruar vdekja dhe kur e pa se jeta e tij është në fund, i la amanet familjes së vet: Kur unë të vdes, mblidhni shumë drunj dhe ndizeni një zjarr derisa ta djegë mishin tim, e kur të mbeten eshtrat e mia, merrini ato dhe shtypini e pastaj në ndonjë ditë me erë hidhni ato në det. Por Allahu e mblodhi prapë dhe i tha: Ç’të shtyu ta bësh këtë? Frika nga Ti – tha ai. Dhe Allahu ia fali atij.*

Ky njeri mohoi fuqinë e Allahut, mirëpo ky mohim ishte nga mosdija dhe Allahu nuk e dënoi për këtë mosdije që kishte, por e fali për shkak të frikës së madhe që kishte ai njeri. Ndaj frika doemos duhet të jetë brenda kufijve të normales, larg ekstremes dhe larg anashkalimit. p.sh. gjersa po përgatisja temën që po lexoni dhe mundohesha të tuboj materialin, kisha një frikë me këtë material, si do ta radhis dhe si do ta rregulloj, çfarë rezultate do të nxjerr që ta realizoj qëllimin për të cilin vendosa të flas për këtë temë e kështu me radhë. Kjo

“...Ndaj frika doemos duhet të jetë brenda kufijve të normales, larg ekstremes dhe larg anashkalimit...”

frikë më shtynte të mbledh informatat, t'i saktësoj ato, të gjej kohë të përshtatshme për ta shkruar, për ta radhitur dhe për ta paraqitur në formën më të mirë që kam mundësi. Kjo frikë është e lëvdur apo e qortuar?

E lëvdur është, sepse ajo është në një sasi të logjikshme dhe normale, që më shpie të bëj një realizim shumë më të mirë sesa do ta kisha bërë pa një frikë të atillë. Mirëpo, sikur kjo frikë: të më kaplonte, të më pengonte nga gjumi i pasdrekes, të më shkaktonte konfuzion dhe të më tolloste barkun për shkak të angazhimit psikik dhe meditimit! Pastaj kjo të më shkakton sjellje të rënda me mysafirët dhe njerëzit që kam përreth! Më afrohet vajza ime, ndërsa unë t'i bërtas dhe e qortoj! Me gruan sillem keq! Madje kjo frikë më bën të mos jem në vete dhe i pakontrolluar! Kjo frikë është e qortuar, sepse e nxjerr njeriun nga kontrolli, ndërsa rrjedhimisht edhe nëse ai e realizon një punë shumë të mirë dhe të madhe, tek ai do të shkaktojë një lloj urrejtje, që sërish nuk do ta merrte përsipër një lloj pune të tillë, sepse do ta kishte vështirë ta mbartë mbi vete këtë gjendje emergjente për çdo javë, apo për çdo ditë.

Tani e ke të qartë pse shumë njerëz i sheh se si ikin prej punëve. Ata nuk dëshirojnë të kenë në brendinë e tyre atë nxehtësi të lartë dhe të padurueshme me të cilën përballen gjatë kryerjes së punës. Këta njerëz në fund i sheh sesi dorëzohen dhe nuk punojnë fare. ■

Përshtati: Omer B.

BIDATET, LLOJET E TYRE DHE GJYKIMI I ISLAMIT MBI TO



Po ashtu ekzistojnë bidate që paraqesin mëkate dhe kundërshtim të Sheriatit dhe natyrshmërisë së pastër, si p.sh: bidati i qëndrimit pa u martuar, agjërimi duke ndenjur në diell, dhe bidati i kastrimit (tredhjes) me arsyen e ndërprerjes së epshit seksual, të gjitha këto me qëllim afrimin dhe përkushtimin sa më të mirë ndaj Allahut.

SALIH IBËN FEUZAN EL FEUZAN

Njerëzit në përkufizimin e risive (bidateve) ndahen në dy grupe:

1. Ata që e teprojnë shumë me çështjen

e bidateve, gjykojnë lehtë ndaj një personi apo vepre me bidat, duke mos pasur argument për një gjë të tillë, aq shumë e zgjerojnë kapitullin e bidateve, sa mund të fusin në të edhe gjëra që janë nga Sheriati dhe nga Suneti.

2. Ata që nënvlerësojnë çështjen e bidateve dhe zgjerohen në praktikimin e tyre, këta e ngushtojnë kapitullin e bidateve duke mos futur në të pos bidateve më të mëdha, dhe kështu sjellja e tyre ka ndikuar, që një numër i konsideruar i bidateve t'i fusin nën nocionin e Sheriatit dhe të Sunetit.¹

Bidatet në fe ndahen në dy lloje:

Bidate në fjalë dhe besim, siç janë thëniet (e kufrit) të xhehmive, muëtezilëve, rafidive dhe të gjithë grupeve të humbura në besim.

Bidate në adhurim, si adhurimi i Allahut me vepra të cilat nuk i takojnë Sheriatit dhe ato janë disa lloje:

1. bidatet që ndodhin në bazë të adhurimit, p.sh.: shpikja e ndonjë namazi të veçantë, të cilin nuk e njeh Sheriati, apo shpikja e ndonjë lloj agjërimi të posaçëm, që nuk ka bazë në fe, apo shpikja e festave të ndryshme, siç është festimi i ditëlindjeve e shumë gjërave të tjera.

2. bidatet që ndodhin në shtimin e ndonjë adhurimi, p.sh.: shtimi e një rekati në namazin e drekës apo ikindisë, duke e bërë atë pesë rekate.

3. bidatet që ndodhin në formën e kryerjes së adhurimit, duke e kryer në formë të panjohur për Sheriatin, p.sh.: praktikimi i lutjeve, madhërimi i Allahut në grupe dhe me zë të lartë, teprimi në adhurime, i cili e tejkalon traditën e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

4. caktimi i një kohe të veçantë, të cilën nuk e ka përcaktuar Sheriati, për

¹ Muhamed Xhizani "Kavaidu marifetil bida'ë".

“Çdo bidat në Islam është i ndaluar, i çfarëdo lloji qoftë ai, dhe ai paraqet humbje e devijim për vepruesin e vet...”

kryerjen e ndonjë vepre, vepër e cila mund të jetë e lejuar në fe, p.sh.: caktimi i ditës dhe natës së mesme të muajit Shaban për agjërim dhe namaz. Edhe pse në esencë namazi dhe agjërimi janë nga veprat e urdhëruara dhe të preferuara në fe, megjithatë veprimi i tyre në një kohë të caktuar (jo nga sheriami) kërkon argument.

Gjykimi i Islamit ndaj bidateve

Çdo bidat në Islam është i ndaluar, i çfarëdo lloji qoftë ai, dhe ai paraqet humbje e devijim për vepruesin e vet, ngaqë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Kini kujdes nga gjërat (veprat) e shpikura, çdo gjë e shpikur (në fe) llogaritet bidat, dhe çdo bidat është humbje.”, dhe hadithi tjetër mjaft i njohur në këtë kapitull: “Kushdo që shpik diçka në fenë tonë, që nuk i përket asaj është e refuzuar.”, pra, hadithi aludon se çdo shpikje në fe është e ndaluar, qoftë në besim apo në vepra.

Mirëpo ndalesa ndryshon varësisht prej llojit të bidatit, sepse ka nga bidatet që është kufër (mosbesim) i qartë, si p.sh: rrotullimi tek varrezat duke synuar adhurimin e tyre, therja e kurbaneve për hir të të vdekurve, që janë në varre, pastaj lutja drejtuar atyre, kërkimi i ndihmës

dhe realizimit të dëshirave nga ata, gjithashtu thënie e disa xhehmive ekstremë dhe muëtezilëve. Pastaj ka bidate që mund të çojnë në shirk (politeizëm) si: ndërtimi mbi varreza, namazi dhe lutja tek varrezat. E nga bidatat ka që janë mëkate të mëdha dhe devijim në besim, siç janë bidatat e havarixhëve, kaderive dhe murxhive në thënie dhe bindjet e tyre të kundërta me argumentet e Sheriatit.

Po ashtu ekzistojnë bidate që paraqesin mëkate dhe kundërshtim të Sheriatit dhe natyrshmërisë së pastër, si p.sh: bidati i qëndrimit pa u martuar, agjërimi duke ndenjur në diell, dhe bidati i kastrimit (tredhjes) me arsyen e ndërprerjes së epshit seksual, të gjitha këto me qëllim afrimin dhe përkushtimin sa më të mirë ndaj Allahut.

Ai që i ndan bidatat në të mira dhe të këqija është gabimtar dhe kundërshtues i fjalës së Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “...dhe çdo bidat është humbje...”. I Dërguari i Allahut ka thënë se: “çdo bidat është humbje”, ndërsa ky thotë: çdo bidat nuk është humbje, ngaqë ka edhe bidate të mira!

Dijetari i njohur Hafidh Ibën Rexhebi – Allahu e mëshiroftë – në komentimin e librit “Dyzet Hadithet” ka thënë se: fjala e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “çdo bidat është humbje” llogaritet nga fjalët shumëkuptimore të Resulullahut, është bazë (shtyllë) nga bazat e fesë dhe i përfshin të gjitha bidatat, i ngjashëm me këtë është hadithi: “Kushdo që shpik diçka në fenë tonë, që nuk i përket asaj është e refuzuar” nga kjo kuptohet se çdokush që shpik diçka dhe ia vesh Islamit, dhe për të cilën nuk ekziston ndonjë bazë në fe, së

cilës mund t’i kthehet, llogaritet humbje dhe devijim, dhe Islami është i pastër nga ato, qoftë ajo në meseletë e besimit apo në vepra e fjalë të jashtme dhe të brendshme”.

Ata që ndajnë këtë mendim (se ekzistojnë bidate të mira), nuk kanë asnjë argument përveç fjalës së Omerit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, në lidhje me namazin e teravive: «sa bidat i mirë që është». E që të këtij lloji janë edhe disa vepra të tjera, të cilat **sahabët dhe të parët tanë të mirë** nuk i ndalonin, si p.sh: mbledhja e Kuranit në një libër (mus-haf), pastaj shkrimi i haditheve dhe përmbledhja e tyre. Ndërsa përgjigjja ndaj këtyre veprave bëhet kështu: se ato janë veprime të bazuara dhe të mbështetura në fe, e nuk janë gjëra të shpikura dhe të pabaza, kurse fjala e Omerit për namazin e teravive: «sa bidat i mirë» ka si qëllim bidatin në aspektin gjuhësor e jo në atë fetar; **sepse bidat në aspektin fetar llogaritet çdo shpikje që nuk ka bazë në fe, tek e cila kthehet vazhdimisht.**

P.sh: mbledhja e Kuranit në një libër ka bazë fetare, siç është saktësuar nga Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që i detyronte shokët e tij me shkrimin e Kuranit, mirëpo ai shkrim ishte në formë dhe vende të ndryshme, prandaj sahabët për ta ruajtur sa më mirë i bashkuan në një libër (mus-haf).

Edhe namazi i teravive ka bazë në fe, ngaqë vetë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ka falur me shokët e tij disa net, ndërsa nga fundi u largua dhe i la ata të falen vetë nga frika se mos po iu bëhet atyre obligim. Sahabët vazhduan të faleshin ashtu të ndarë derisa ishte gjallë i Dërguari i Allahut dhe një kohë pas

vdekjes së tij, kur erdhi Omeri i bashkoi ata në një namaz, pas një imami mu ashtu si faleshin pas të Dërguarit të Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe kjo nuk është diçka e shpikur në fe.

Gjithashtu shkrimi i haditheve ka bazë në fe, kur Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ka urdhëruar disa nga shokët e vet t'i shkruajnë disa hadithe, kur kjo gjë u kërkua nga disa sahabë të tjerë. Shkrimi dhe përmbledhja e të gjitha haditheve ka qenë e ndaluar në kohën e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nga frika e përzierjes me Kuranin diçka që nuk është prej tij, mirëpo pas vdekjes së Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u hoq kjo ndalesë, sepse në atë kohë u plotësua Kurani dhe nuk ekzistonte më ajo frikë. Kështu që sahabët dhe dijetarët pas tyre filluan shkrimin e haditheve kudo që ata gjendeshin, me të vetmin qëllim ruajtjen e tyre nga humbja. Allahu i Lartësuar i shpërbleftë ata njerëz me të mira ndaj Islamit dhe muslimanëve, pasi e ruajtën Librin e Zotit të tyre dhe Sunetin e Profetit nga humbja dhe nëpërkëmbja e të kotëve.

Shkëputur nga libri “El Irshad ila sahihil litikad ue raddu ala ehli shirki ue ilhad” i dijetarit Salih ibën Fevzan el Fevzan. ■

Përshtati: R. ZYLFIU

HUAJA DHE DISA NGA DISPOZIT AT E SAJ

Nëse dikush jep hua jo për hir të Allahut dhe për ta ndihmuar nevojtarin, mirëpo për të pasur merita ndaj tij, dhe të shfrytëzojë autoritetin ose pozitën e tij në raste të ndryshme, kjo është e ndaluar

SHKRUAN: LLOKMAN HOXHA

Në gjuhën arabe kemi dy shprehje të cilat përdoren me kuptimin e huasë:

1. fjala: “dejn” të cilën mund ta përkthejmë si “borxh”, që nënkupton gjithçka që bie mbi përgjegjësinë e dikujt ndaj tjetrit, dhe kjo ndodh me anë të njërës

nga tri gjërat që janë: kontrata, shfrytëzimi dhe huaja, ku edhe në shqip borxhi ka kuptim më të gjerë se sa vetëm për huadhënie, dhe

2. fjala “kard” të cilën mund ta përkthejmë si “hua”. Shpeshherë përdoret njëra në vend të tjetrës, por dallimi është se çdo hua (kard) është borxh (dejn) dhe jo e kundërta, ngase huaja (kard) përdoret vetëm për huazimin e parave. Huaja në gjuhën shqipe nuk ka të bëjë vetëm me paratë, por edhe më gjësede të tjera, në këtë temë kur përmendet huaja për qëllim është huaja e parave.

Huaja në përkufizimet e fukahave do të thotë “Dhënia e parave për shfrytëzim për t’i kthyer ato më vonë”. Huadhënia përveç që është legjitime ajo është edhe e preferuar, madje inkurajimi për të është i qartë në librin e Allahut dhe Sunetin e Resulullahit (lavdërimi i Allahut dhe paqja qofshin mbi të). Në disa ajete Allahu e përmend huadhënien, duke e kërkuar atë për Vetën gjë e cila ia ngre vlerën lart huadhënies: **“Ata që japin lëmoshë e që i japin Allahut një hua të mirë, qofshin burra ose gra, do t’u shumëfishohet përfitimi dhe do të kenë një shpërblim fisnik.”** (Hadid: 18), ajete të ngjashme janë të shumta në Kuran.

Po ashtu nga hadithet, të cilat legjitimojnë huan është ai që përcjell Buhariu nga Ebu Hurejre, se lajmëtari i Allahut ka thënë: **“Kush iu merr njerëzve para, me qëllim që t’i kthejë ato, Allahu i kthen për të. Kush iu merr njerëzve para me qëllim t’i shfrytëzojë (asgjësojë) ato,**



Allahu e asgjëson atë". Dijetarët muslimanë kanë rënë në konsensus për lejueshmërinë e huas së mirë. Sidomos kur dihet se huaja e mirë ka urtësi të shumta, ku njeriu mësohet të japë nga pasuria e tij, dhe kjo çrrënjës nga shpirti farën e koprracisë, si dhe vë në dukje parimin e vëllazërisë, i cili duhet të mbizotërojë në shoqëri duke praktikuar fjalën e Allahut **"Vërtetë besimtarët janë vëllazër."** (Huxhurat: 10) Me legjitimitetin e huas realizohet parimi i solidaritetit dhe mbështetjes në mes muslimanëve, duke praktikuar fjalën e Allahut: **"Ndihmohuni në të mira dhe devotshmëri, e mos u ndihmoni në të këqija dhe armiqësi."** (Maide: 2).

Si të ruhet huaja? Meqenëse njerëzit nuk janë të gjithë zemërbardhë dhe shumë prej tyreve u është njollosur natyrshmëria humane, ndonëse gjërat mund të ndodhin edhe pa qëllim të keq, për këtë Islami ka ligjësuar disa gjëra me anë të cilave ruhen kontratat nga shtrembërimi, dhe mbrohen të drejtat nga mohimi, gjë e cila ndikon që transaksionet të jenë më të pastra dhe më aktive, dhe dijetarët muslimanë kanë preferuar që çdo kontratë të ruhet me një nga metodat që do të përmenden në vijim, madje disa këtë e konsiderojnë si obligim. Nga metodat për ruajtjen e huas janë:

1. Shkrimi: është prej metodave më të mira për ruajtjen e informatave nga humbja apo shtrembërimi, dhe është metodë e vjetër në historinë e njerëzimit, të cilën Kurani e ka vlerësuar dhe na ka porositur që me rastin huas të jemi të kujdesshëm në shkrimin e saj dhe kjo bëhet në ajetin më të gjatë në Kuran, ku thuhet: **"O besimtarë! Shkruajeni huan që**

“...Kush iu merr njerëzve para, me qëllim që t’i kthejë ato, Allahu i kthen për të. Kush iu merr njerëzve para me qëllim t’i shfrytëzojë (asgjësojë) ato, Allahu e asgjëson atë...”

ia jepni njëri-tjetrit për një afat të caktuar. Le ta shënojë atë me drejtësi një shkruer ndërmjet jush; asnjë shkruer të mos ngurrojë që ta shënojë ashtu siç e ka mësuar Allahu. Ai le të shënojë, kurse borxhliu le të diktojë dhe le t’i frikësohet Allahut, Zotit të vet, duke mos lënë mangët asgjë nga borxhi! Në qoftë se borxhliu është mendjelehtë ose i mitur, ose i tillë që nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë saktësisht kujdestari i tij.” (Bekare: 282).

2. Dëshmia është gjithashtu nga metodat me të cilat ruhet huaja nga humbja ose shtrembërimi. Allahu në Kuran thotë: **"Thirrni dy dëshmitarë prej njerëzve tuaj e nëse nuk gjeni dy dëshmitarë burra, atëherë thirrni për dëshmitarë një burrë dhe dy gra, nga ata që i quani të përshtatshëm; në mënyrë që, nëse njëra grua harron, t’ia kujtojë tjetra. Dëshmitarët nuk duhet të kundërshtojnë kurdo që të thirren."** (Bekare: 282).

3. Garancia (dorëzania), që do të thotë me rastin e huas është e lejuar që huadhënësi të kërkojë garanci (dorëzanë) nga huamarrësi, që me rastin e moskthimit të huas përgjegjësia bie mbi dorëzanin. **"Thanë: "Po kërkojmë gotën e**

mbretit. Kush e sjell atë, ka shpërblim një barrë deveje ushqim. Unë për këtë jam dorëzënës". (Jusuf: 72).

4. Marrja peng është prej metodave më të rëndësishme për të ruajtur huan e huadhënësit dhe për të mundësuar kthimin e saj, dhe me rastin e pamundësisë së kthimit shitet pengu dhe lahet borxhi, nëse mbetet diçka tepricë i kthehet pronarit të pengut. ***"Nëse jeni në udhëtim e nuk gjeni shkrues, atëherë merrni peng."*** (Bekare: 283). Enesi tregon se: *"Resulullahi kishte lënë peng mburojën e tij për disa masa elb që kishte marrë (nga një çifut)"*. (Buhariu)

"Çdo hua e cila sjell dobi (interes) është kamatë"

A është çdo interes që sjell huaja kamatë apo ka disa nga to që nuk ndalohen në Islam, dijetarët i kanë ndarë interesat fillimisht në dy lloje:

Interesa të kushtëzuara në kontratë dhe kjo shfaqet në disa forma:

Kushtëzimi i rritjes së sasisë së huas në kthim, që njihet si kamatë.

Kjo s'ka dyshim se është e ndaluar dhe për këtë nuk diskuton askush, Allahu thotë: ***"Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën."*** (Bekare: 275).

Kushtëzimi i një vendi tjetër ku do të kthehet huaja për dallim nga vendi ku është marrë.

Nëse ky kusht është në interes të dy palëve, dhe sidomos të huamarrësit është i lejuar, ngaqë esenca e huadhënies është bamirësia ndaj huamarrësit, dhe përderisa në këtë bamirësi shtohet edhe lehtësimi i vendit të kthimit, kjo nuk e bën të ndaluar huamarrjen, edhe nëse huadhënësi

"Nga ky rregull përjashtohet ajo që ndodh në mes studentëve ose grupeve të ndryshme, të cilët formojnë një fond ku secili jep një shumë çdo muaj për të marrë hua pastaj sipas nevojës..."

konkretisht nuk ka ndonjë interes.

Kushtëzimi i afatit për kthimin e huas, është i lejuar dhe nuk konsiderohet nga interesat e ndaluara.

Kushtëzimi i dhuratës për atë që mundëson huamarrjen, si të thotë: më gjej një hua 100 euro, 10 euro t'i jap ty! Kjo nuk është e lejuar përveç nëse personi ka shpenzuar diçka për të arritur deri te marrja e huas në këtë rast i paguhen harxhimet si udhëtimi etj., ndërsa vetëm për shfrytëzimin e autoritetit të tij nuk lejohet të paguhet asgjë.

Kushtëzimi i huas për hua, pra huadhënësi të thotë: të jap hua, nëse më jep hua më vonë, qoftë në raport me bankën apo individin, kjo nuk lejohet ngase huamarrësi dëmtohet me dhënien e huas, duke u detyruar t'ia ndërrojë destinimin të hollave pa dëshirën e tij, të cilat i ka planifikuar për diçka tjetër, ndërsa huadhënësi dëshiron që me huan e dytë të kompensojë zbrazëtimin e shkaktuar me huadhënien e parë.

Nga ky rregull përjashtohet ajo që ndodh në mes studentëve ose grupeve të ndryshme, të cilët formojnë një fond ku secili jep një shumë çdo muaj për të marrë

hua pastaj sipas nevojës, ngase në këtë rast kjo bëhet në formë vullnetare dhe humane.

Interesat e pakushtëzuara në hua, ndahen në dy grupe:

Interesa materiale

Theksuam konsensusin për ndalesën e interesave materiale të kushtëzuara, qoftë ai interes në fillim të kontratës apo në fund, ndërsa për interesat e pakushtëzuara, më i sakti nga mendimet e dijetarëve është se lejohen kur shtesa nga ana huamarrësit bëhet nga dëshira e tij në shenjë mirënjohjeje dhe bamirësie, madje kjo është e preferuar ashtu si na është përcjellë nga Ebu Hurejre, se i Dërguari i Allahut –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të- kishte huazuar një kafshë dhe kur e kishte kthyer kishte dhënë një kafshë më të mirë për nga cilësia, dhe kishte thënë: *“Më të mirët nga ju janë më mirënjohësit në larjen e borxhit.”* (Nesaiu).

Interesat e pakushtëzuara gjatë afatit të huas, pra, para kthimit të saj, si t'i japë ndonjë dhuratë, apo t'ia lehtësojë ose ta ndihmojë në ndonjë punë. Nëse ky veprim vjen si rezultat i huas dhe për shkak të saj, nuk lejohet, sepse është një lloj mite, që huadhënësi të jetë më tolerant me huamarrësin, ose t'ia shtyjë afatin, ose t'i huazojë prapë etj., si dhe është interes i huadhënësit përballë huas së dhënë. Nëse ky veprim nuk bëhet për shkak të huas, por ka qenë zakon i tij dhe raporti mes tyre nuk ka ndryshuar para dhe pas huas, është e lejuar. Por duhet ditur se kamata që jepet nga bankat konvencionale nuk është në emër të bamirësisë dhe mirënjohjes.

Interesa jo materiale (morale)

“...Muslimani gjithmonë duhet të jetë i kujdesshëm që ta kthejë huan sa më parë, dhe ta pastrojë veten nga kjo përgjegjësi përpara se të vijë momenti i vdekjes, sepse borxhi nuk i falet as shehidit...”

Falënderimi, lavdërimi dhe lutja për huadhënësin, ky interes për huadhënësin është i lejuar dhe madje i inkurajuar për huamarrësin, Ibën Omeri rrëfen se Resulullahi –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të- ka thënë: *“Kur dikush ju bën ndonjë të mirë shpërblejeni, po nëse nuk keni atëherë lutuni për të, aq sa mendoni se e keni shpërblyer.”* (Ebu Davudi).

Interesi i huadhënësit nga autoriteti i huamarrësit, nëse dikush jep hua jo për hir të Allahut dhe për ta ndihmuar nevojtarin, mirëpo për të pasur merita ndaj tij, dhe të shfrytëzojë autoritetin ose pozitën e tij në raste të ndryshme, kjo është e ndaluar.

Etika e huas: Meqenëse huaja është prej gjërave me të cilat synohet bamirësia dhe lehtësimi ndaj nevojtarit në Islam ka një etikë, së cilës duhet t'i përmbahen, edhe huadhënësi, edhe huamarrësi.

Etika që ka të bëjë me huadhënësin:

Pritja e borxhliut dhe lehtësimi ndaj tij.

Ebu Hurejre tregon se i Dërguari i Allahut –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut

qoftë me të- ka thënë: “Një tregtar u jepte hua njerëzve dhe kur e shihte ndonjë (huamarrës), që ishte në gjendje të vështirë u thoshte djelmoshave të tij tejkalojeni (faleni) ndoshta Allahu na tejkalon neve, e Allahu e tejkaloi (fali) atë”. (Buhariu).

Toleranca dhe mirësjellja me huamarrësin gjatë kërimit të kthimit të huas dhe marrjes së saj, Xhabiri tregon se i Dërguari i Allahut –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të- ka thënë: “Allahu e mëshiroftë një njeri, i cili është tolerant (i lehtë) në shitje, në blerje dhe në hua.” (Buhariu).

Falja e borxhit ose një pjese të tij, Allahu në librin e tij thotë: “**Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin** (e shlyerjes së borxhit) **derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t’ia falni borxhin, veç sikur ta dinit.**” (Bekare: 280). Kurtubiu duke komentuar fjalën “**të jepni lëmoshë është më mirë**” do të thotë se të dhënit lëmoshë huamarrësit, përkatësisht falja e tij, është më e mirë tek Allahu, se sa pritja ose shtyrja e afatit.

* vërejtje: nuk lejohet falja e borxhit të llogaritet si pjesë e zekatit, por duhet dhënë të hollat, pastaj huamarrësi është i lirë të kthejë huanë ose t’i shpenzojë për nevoja të tjera.

Etika që ka të bëjë me huamarrësin:

Kthimi i huas në formën më të mirë, më lart përmendëm vlerën që i Dërguari i Allahut –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të- ka treguar për mirënjohësit në larjen e borxhit, si dhe vetë ai kur e kthente huan jepte më tepër nga vetja.

Mosvonimi i huas, vonimi i kthimit të huas pa arsye është i ndaluar fetarisht dhe

është një padrejtësi e madhe për të cilën i Dërguari i Allahut –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të- ka thënë: “*vonimi i kthimit të huas nga ana e atij që ka mundësi ta kthejë atë, lejon përfoljen dhe ndëshkimin e tij.*” (Nesaiu).

Kujdesi për ta larë borxhin, muslimani gjithmonë duhet të jetë i kujdesshëm që ta kthejë huan sa më parë, dhe ta pastrojë veten nga kjo përgjegjësi përpara se të vijë momenti i vdekjes, sepse borxhi nuk i falet as shehidit, dhe borxhliu nuk është i qetë në varr deri sa t’i lahet borxhi, siç është e njohur kjo nga hadithet e të Dërguarit të Allahut –lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të.

A është më e vlefshme lëmosha apo huaja? Rreth kësaj çështje ekzistojnë disa hadithe të dobëta që bëjnë dallimet në vlerësimin e njërës ndaj tjetrës, si dhe dijetarët kanë diskutuar duke thënë se huan e merr vetëm ai që ka nevojë, ndërsa lëmosha mund të bjerë në dorë të jo-nevojtarit etj.

Por mendimi më i saktë është se vlera e saj shtohet varësisht nga përfitimi prej saj dhe cili është më i nevojshëm për të: Lëmosha për nevojtarin është më e mirë se sa huaja për jo-nevojtarin, huaja për nevojtarin është më e mirë se lëmosha për jo-nevojtarin. Nëse që të dy janë të barabartë, pra që të dy janë nevojtarë, lëmosha është më e vlefshme, sepse lëmosha nuk ka kompensim dhe njeriu e jep atë vetëm për Allahun, ndryshe nga huaja ku huadhënësi pret kthimin e saj. Allahu e di më së miri. ■

ËNDRRAT E GRAVE



mendoj se gratë arabe si puna e Budejrit dhe të tjera si ajo i kanë mundësitë që ta përkrahin çështjen e gruas pa i nxitur vajzat e gjinisë së saj drejt një përcërimi më të madh me arsyetimin se kjo e bën burrin që ta ndjejë sesa gabim e ka pasur. Kjo është një metodë perverse, sepse nuk mundet që të flasim në emër të gruas dhe në të njëjtën kohë të kërkojmë poshtërimin e saj.

SHIJMA NUMAN

Pavarësisht nga idetë dhe mendimet e devijuara që na nxjerr çdo ditë kultura perëndimore, siç është martesë mes dy gjinive të njëjta, apo sistemi i shokut dhe i shoqes (girlfriend and boyfriend), apo disa thirrje feministe shumë të çuditshme, siç është kërkesa për regjistrimin e emrave me emrin e nënës në vend të emrit të babait, por ajo që më tërhoqi vëmendjen së fundmi është thirrja e shkrimtares Nadin el Budejr, në lidhje me të drejtën e martesës me më shumë se një burrë për gratë, ashtu si dhe për burrat në lidhje me gratë. Gjithashtu më tërhoqi vëmendjen thënia e saj, se gruaja brenda Gadishullit Arabik e ëndërron diçka të tillë.

Nuk do të përfshihem në mbrojtjen e urtësisë hyjnore në lejinin e poligamisë për burrat dhe shkaqet e këtij lejimi, por për sa

i përket gruas me natyrë të shëndoshë – cilado qoftë feja dhe nacionaliteti i saj – duhet që kjo fjalë për atë të jetë një fatkeqësi dhe jo një ëndërr, që të martohet me më shumë se një burrë, madje të lidhet me zemër dhe me ndjenja me më shumë se një burrë.

Një ulërimë e provokuar kërceu lart nga të gjitha pjesët e trupit tim kur po lexoja ato mendime që bien ndesh me natyrën e pastër njerëzore dhe që kundërshtojnë të gjitha orientimet e pranueshme në jetën njerëzore përgjatë shekujve. Ajo është një ulërimë që e kundërshton faktin që çdo shkrim si ky para njerëzve të jetë diçka që shpreh ndjenjën e pastër dhe të butë të gruas dhe besnikërinë e saj të singertë, të cilën Allahu e ka zbkuruar dhe e ka kulluar nga çdo sjellje e ulët.

Cilido qoftë qëllimi i këtyre artikujve të pacipë (sepse autorja e këtyre artikujve

përpiqet gjithmonë të shpjegojë se qëllimi i saj nuk është thirrja drejt martesës me më shumë se një burrë, apo me më shumë se një grua, por qëllimi është provokimi i lexuesit për t'i dhënë rëndësi të drejtave të grave), ajo është përpjekur që të kalojë drejt qëllimeve të saj përmes cenimit mendjelehtë të grave muslimane dhe të pastra... madje përmes cenimit të gruas që dëshiron të respektojë vetveten në të gjithë botën.

Le ta imagjinojmë së bashku këtë skenë qesharake, se si mund të jetë imazhi i jetës së dëshpëruar nëse gruaja do të kishte mundësinë që të bëjë bashkë më shumë se një bashkëshort në të njëjtën kohë – pa marrë parasysh natyrën femërore, e cila fsheh brenda saj dëshirën për ndjesinë e sigurisë, stabilitetit dhe qetësisë në jetë.

Para nesh do të shfaqet një formë e paimagjinueshme e një gruaje të shqyer nga numri i madh i peshave të përgjegjësive, një grua që luhatet në mesin e natyrave të ndryshme mashkullore në vende jetese të ndryshme – vetëm nëse natyrisht – merr përsipër që të fashitë edhe më shumë burrërinë, duke i mbledhur të gjithë ata burra në një shtëpi të vetme.

Le të imagjinojmë që ajo do të caktojë njërin prej tyre si kujdestarin e shtëpisë, tjetrin si baba të fëmijëve, të tretin për t'i plotësuar nevojat trupore dhe të kërkojë nga i katërti që të shtyjë monotoninë martesore që mund ta mbysë jetën e saj. Çfarë loje e keqe është kjo dhe çfarë shpërfillje e madhe është për feminitetin?

Autorja është përpjekur me më shumë se një mënyrë – pasi e ka ndjerë që është përzier në ide të devijuara- që t'i përcjellë lexuesve të saj se nuk ka për qëllim atë ç'ka kuptojnë njerëzit – të gjithë njerëzit- nga thirrja e saj për të pasur një numër bashkëshortësh apo çfarëdo lloj shturje në këtë mes, porse është përpjekur që të

“Allahu nuk e ka krijuar mashkullin dhe femrën për gjë tjetër përveçse për të qenë bashkudhëtarë dhe secili prej tyre do të kryejë ato funksione për të cilat është krijuar...”

tërheqë vëmendjen ndaj zbatimit të drejtësisë me gruan. Edhe nëse unë përpiqem që të supozoj saktësinë e asaj që pretendon autorja, nga ana tjetër do të ketë një lumë me refuzime me të cilin do të përballlet shkrimi i saj nga lexuesit e saj, ndërkohë që ajo po rendit fjalët e saj që godasin si një hanxhar parimet dhe vlerat.

Po aq sa më frikësoi kjo ide, po me të njëjtën forcë ndjeva thellë kuptimin e ajetit në të cilin Allahu i Lartësuar thotë: ***“A nuk e di Ai se çfarë ka krijuar, kur Ai është i Buti, i Gjithëdituri?”***

Me të vërtetë, Ai është i Buti, i Gjithëdituri, i Cili e njeh natyrën e gruas dhe e njeh mjaft mirë atë që i bën mirë zemrës, shpirti, trupit dhe nefsit të saj. Ai e di mjaft mirë atë që i bën dobi asaj sot dhe nesër, atë që e bën të suksesshme në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar ka ligjëruar për të një fe me vlerë dhe një rrugë të shkëlqyeshme, të cilat mbrojnë të drejtat e saj, që ruajnë vlerën e saj, që kujdesen për nevojat e saj dhe ngrenë lart vlerën e saj.

Nadin el Budejri dëshiron të flasë për dhembjet e gruas nën hijen e atyre shoqërive, që janë larg vlerave dhe të drejtave, të cilat mund të ndërmarrin padrejtësi dhe persekutime kundër saj me gjak të ftohtë dhe me pretendimin se kjo është prej fesë. Mund të jem dakord me të

për një pjesë të kësaj që thotë në disa raste, edhe pse mendoj se gratë arabe si puna e Budejrit dhe të tjera si ajo i kanë mundësitë që ta përkrahin çështjen e gruas pa i nxitur vajzat e gjinisë së saj drejt një përçmimi më të madh me arsyetimin se kjo e bën burrin që ta ndjejë sesa gabim e ka pasur. Kjo është një metodë perverse, sepse nuk mundet që të flasim në emër të gruas dhe në të njëjtën kohë të kërkojmë poshtërimin e saj.

Unë mendoj se çështja e mbrojtjes së gruas fillon me arsimin e gruas që kur është fëmijë dhe me edukimin e saj në mënyrë që të krijojë një brez, që nuk e pranon poshtërimin dhe padrejtësinë.

Islami i ka dhënë gruas të drejtën e dijes, të drejtën për të zgjedhur bashkëshortin, të drejtën për t'i sjellë dobi shoqërisë dhe një siguri pasurore të pavarur dhe nuk e ka hedhur drejt traditave dhe zakoneve të trashëguara për të cilat Allahu nuk ka zbritur asnjë argument.

Nëse në shtëpitë e Islamit në lindje dhe në perëndim të tokës do të mbinte bima e vajzës që nuk privohet nga arsimi për faktin se është vajzë, apo sepse detyrohet nga burri për faktin që është grua, apo nëse trajtohet si një qytetar i gradës së dytë nëse e divorcon bashkëshorti i saj, atëherë do të shfaqet një brez i ri, ku burrat dhe gratë e tij do të përkrahin njëri-tjetrin. Objektivi është i njëjtë dhe Allahu nuk e ka krijuar mashkullin dhe femrën për gjë tjetër përveçse për të qenë bashkudhëtarë dhe secili prej tyre do të kryejë ato funksione për të cilat është krijuar.

E vërteta qëndron se gratë lidere të lëvizjes feministe në shoqëritë arabe gjithmonë qëndrojnë larg çdo fizionomie të kulturës islame, ndoshta për të fituar përkrahjen emocionale evropiane, ose ndoshta për shkak të ndonjë dobësie apo mangësie në të kuptuarin e natyrës së fesë së tyre. Ka shumë shembuj që të japin

“...Se Islami i vërtetë është besim dhe legjislacion që mund të përballojë ëndrrat dhe dhembjet e njeriut, qoftë ky mashkull apo femër...”

ndjesinë se Islami është një pengesë mes gruas dhe lirisë së saj. Atëherë çfarë të keqe do të kishte nëse aktivistja arabe e të drejtave të njeriut, e cila mbron të drejtat e vajzave të gjinisë së saj, që të vishte rrobën islame duke shpallur se feja nuk e kishte ndaluar që të merrte dije, të ishte e lirë, apo që të kishte të drejtën e zgjedhjes apo që të shprehte mendimin e saj?

Mund të ngushëlloj shumë ide të cilat Nadina përpiket t'i përcjellë tek njerëzit për t'u zhytur në kulturën perëndimore të zhveshur nga formimi edukativ i njeriut ashtu siç e ngushëlloj një natyrë edukative që është prekur nga një lloj shtypjeje ose ndrydhje të të drejtave gjatë periudhave të jetës, ndërkohë që dikush tjetër përveç saj bën thirrje drejt një revolucionit shtypës ndaj çdo kufiri, edhe nëse ky i fundit është i logjikshëm, bindës, i shenjtë dhe nuk prek asgjë nga të drejtat e tyre (grave), ndërkohë që ajo vetë me dijen e saj nuk e ka sqaruar përkatësinë e saj tek një fe e caktuar.

Nisur nga pozicioni im i afërt me kulturën perëndimore dhe nga kontaktet e mia deri diku të afërta me të, për shkak të natyrës së studimit dhe punës sime, mund të them se Islami i vërtetë është besim dhe legjislacion që mund të përballojë ëndrrat dhe dhembjet e njeriut, qoftë ky mashkull apo femër, në çdo kohë dhe në çdo vend, kudo që të jetë nacionaliteti i tij, rritja dhe atdheu i tij. ■

MBAJENI FRYMËN E RAMAZANIT GJALLË!

Por tani që mbaroi Ramazani shumica jonë për fat të keq do ta vënë Kuranin prapë në raftet e tyre, do ta ndërpresin agjërimin deri në vitin e ardhshëm dhe do ta braktisin namazin e natës. Kjo nuk është rruga që duhet të ndjekim, sepse të gjitha veprimet e adhurimit kanë shpërblime dhe janë në dobinë tonë për gjatë gjithë vitit

SUMEJA XHON

Pas hyrjes në muajin e Shevalit, nuk duhet t'i lëmë pas dore shumë vepra adhurimi, që i kemi kryer gjatë muajit të bekuar të Ramazanit. Ramazani për shumicën tonë është një kohë e ripërtëritjes dhe e ringritjes së përkushtimit tonë ndaj Allahut dhe fesë së Tij.

Agjëruam, dhamë në bamirësi, lexuam Kuran dhe falëm namazin e natës. Iu shmangëm përgojimeve, thashethemeve,

shpifjeve dhe çdo të keqe, e cila do të zhvlerësonte agjërimin tonë. Por tani që mbaroi Ramazani shumica jonë për fat të keq do ta vënë Kuranin prapë në raftet e tyre, do ta ndërpresin agjërimin deri në vitin e ardhshëm dhe do ta braktisin namazin e natës. Kjo nuk është rruga që duhet të ndjekim, sepse të gjitha veprimet e adhurimit kanë shpërblime dhe janë në dobinë tonë për gjatë gjithë vitit, veç faktit se nuk ka udhëzim hyjnor, që i kufizon këto vetëm në Ramazan.

Kurani

Është e dhimbshme, por e vërtetë, që shumë prej nesh kanë rënë në shprehinë e keqe e të lexuarit Kuran vetëm gjatë muajit të Ramazanit. Duke e bërë këtë ne e privojmë veten nga shpërblimet e shumta, të cilat vijnë nga leximi i fjalës së Allahut. Leximi i Kuranit është mënyra më e mirë për të kujtuar Allahun, është mbrojtje nga shejtani dhe aty është shërimi për atë që na shqetëson (sëmundjen). Për këtë Allahu thotë: ***“O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kurani) dhe shërimi i asaj që gjendet në krahavarorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët.”*** (Kuran; 10: 57)

I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Kush lexon një harf - shkronjë nga Libri i Allahut (Kurani), do të ketë shpërblim, e shpërblimi do të dhjetëfishohet. Unë nuk them që `Elim Lam Mim` është një harf - shkronjë, por `Elif` një shkronjë, `Lam` është një shkronjë dhe `Mim` është një shkronjë.”* Tirmidhi

Kurani gjithashtu është mënyra më e mirë për robin për t'u afruar më afër Zotit të tij/saj. Habab Ibën Erati, -Allahu qoftë i kënaqur me të-, i tha një njeriu: “Afroju Allahut sa më shumë të mundesh, dhe mbaje mend se mund ta bësh këtë ashtu që në asnjë mënyrë nuk është më e kënaqshme tek Ai, se sa nga fjalët e Tij (d.m.th. me Kuranin).”

Namazi i Natës

Shumë prej nesh kanë kaluar net të muajit të Ramazanit, sidomos dhjetë netët e fundit, duke qëndruar me lutje para

“Gjatë gjumit tuaj shejtani i lidh tre nyje prapa kokës së secilit prej jush, dhe i fryn duke thënë këto fjalë në secilën nyje: “Nata është e gjatë, vazhdo e fle..”

Allahut. Vetëm për shkak se Ramazani po përfundon, nuk do të thotë se Allahu nuk na sheh tashti nëse qëndrojmë në namaz nate. Allahu thotë: ***“Zoti yt e di se ti (O Muhamed) dhe një grup i atyre që janë me ty kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës, ose gjysmën e saj, ose një të tretën e saj...”*** (Kuran; 73:20)

I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *“Namazi më i mirë, pas namazit të detyrueshëm është namazi i natës.”* Muslimi

Namazi i natës mbart me vete shumë të mira. Për shembull, Hasani, -Allahu e mëshiroftë-, u pyet: “Si është e mundur që ata që qëndrojnë natën kanë fytyra më tërheqëse?” Ai, -Allahu qoftë i kënaqur me të-, u përgjigj: “Për shkak se ata janë në marrëdhënie të afërta me Mëshiruesin, dhe Ai i zbukuron ata me pjesë nga drita e Tij.”

E për ata nga ne që mendojnë se qëndrimi në namazin e natës do të na bëjë të lodhur dhe të paaftë për të dalë për detyrat tona të përditshme në mëngjes, duhet të marrim në konsideratë fjalët e mëposhtme të të Dërguarit të Allahut. Ai, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: ***“Gjatë gjumit tuaj shejtani i lidh tre nyje prapa kokës së secilit prej jush, dhe i fryn duke***

thënë këto fjalë në secilën nyje: “Nata është e gjatë, vazhdo e fle”. E nëse zgjohet dhe e përmend Allahun, i zgjidhet një nyje, nëse merr abdes i zgjidhet një nyje tjetër, e nëse falet i zgjidhet edhe nyja e fundit, atëherë gdhin shpirtmirë dhe aktiv. Përndryshe shndërrohet në shpirtkeq dhe dembel.” Buhariu

Agjërimi

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “Kush agjëron një ditë për hir të Allahut, Allahu do të vendosë në mes tij dhe Zjarrit një hendek sa largësia mes qiellit dhe Tokës.” (Tirmidhi). Po kështu agjërimi fshin të këqijat që dalin nga pasuria e njeriut, familja ose fqinji. Hudhejfe ibën Jemani, Allahu qoftë i kënaqur me të, rrëfen se i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Të këqijat që i janë shkaktuar një njeriut përmes familjes së tij, pasurisë dhe fqinjit shlyhen nga namazi, agjërimi dhe bamirësia.” Buhari.

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, na ka shpjeguar se agjërimi na mbron nga dëshirat tona të ndaluara, na mbron prej Zjarrit dhe na afron më afër Allahut dhe Xhenetit të Tij. Ai, *sal-lallahu alejhi ue selem*, gjithashtu na inkurajoi të agjërojmë të paktën tri ditë të çdo muaji. Ditët më të mira për agjërim vullnetar janë të hënat dhe të enjtet, ose e trembëdhjeta, katërmëdhjeta dhe e pesëmbëdhjeta ditë e muajit hënor.

Bamirësia

Allahu e ka begatuar shumicën prej nesh, që të bëjmë një jetë relativisht

komode. Por ekzistojnë muslimanë në të gjithë botën, të cilët hasin në vështirësi të mëdha për arritjen e nevojave elementare të jetesës. Gjatë Ramazanit shumica prej nesh bëjnë bamirësi, por ne harrojmë ta bëjmë këtë për pjesën tjetër të vitit. Dhënia e bamirësisë është begatia më e madhe e atij që e jep atë, sesa e atij që e merr atë. Ajo është një mjet pastrimi i pasurisë sonë, rritjes së besimit dhe arritjes së drejtësisë. Allahu thotë: **“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, pejgamberëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, dhe udhëtarëve...”** Kuran; 2: 177.

Dhënia e bamirësisë gjithashtu na lejon neve që të shprehim besimin tonë. Me të vërtetë na bën ta shijojmë ëmbëlsinë e imanit, sepse duhet të duam për vëllezërit dhe motrat tona atë që duam për vete. Për këtë Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “Asnjë nga ju nuk ka besuar deri sa të dojë për vëllanë e tij (musliman) atë që do për vete.” Buhariu.

Pra agjërimi, namazi i natës, leximi i Librit të Allahut dhe dhënia e lëmoshës nuk duhet të bëhen vetëm në Ramazan. Këto vepra të mira dhe të tjerat si qëndrimi larg thashethemeve dhe shpifjes janë të gjitha gjëra, që ne duhet t'i bëjmë gjatë gjithë kohës. Duke e mbajtur frymën e Ramazanit gjallë gjatë gjithë vitit, ne mund ta mbrojmë fenë tonë dhe do të jemi në gjendje të kapim shumë mundësi për të fituar mëshirën dhe bekimin e Allahut. ■

Nga anglishtja: Drita MALIQI

PËRSOSMËRIA E FESË ISLAME

"...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe." Maide 3.

SHKRUAN: ALI SHABANI

Allahu i Madhëruar në këtë ajet ka përmendur tre gjëra:

- përsosmërinë e fesë,
- plotësimin e begative ndaj muslimanëve dhe
- kënaqësinë ndaj fesë islame.

Kjo është begatia më e madhe e Allahut të Madhëruar për këtë umet. Ua ka plotësuar fenë dhe nuk kanë nevojë për fe tjetër, as pejgamber tjetër. Për këtë arsye Allahu i Madhëruar e ka bërë edhe Pejgamberin e këtij umeti vulë të pejgamberisë, duke e dërguar te të gjithë njerëzit dhe xhindet. Kur ai ishte në Meke vetëm namazi ishte bërë i obliguar, e më pas në Medine vijuan edhe detyrimet e tjera si agjërimi i muajit të Ramazanit, zekati dhe më në fund kur e bëri haxhin zbriti ky ajet: ***"...Sot përsosa për ju fenë tuaj,***



“Pas këtij Ajeti besimtarët muslimanë nuk kanë më nevojë për ndonjë shtesë kurrë. Allahu e ka plotësuar fenë dhe nuk i mungon fesë islame asgjë, Ai është i kënaqur me këtë fe dhe nuk do ta urrejë asnjëherë...”

plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe.” Transmetohet se ky ajet ka zbritur në ditën e haxhit të Madh, gjegjësisht në ditën e Arafatit. Kur e ka recituar Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* këtë ajet, Omer ibënHatabi radijallahu anhu ka qarë. I Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* e pyeti: *Çfarë të bëri të qash?* Tha: Më bëri të qaj, se ne vazhdimisht na shtohet feja, e tani është plotësuar, e nuk ka gjë që plotësohet, e mos ta pasojë mungesa.- Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* i tha: *Ke thënë të vërtetën.”* IbënKethiri, Kurtubiu, Sheukani e të tjerë përmendin hadithin që e transmetojnë Buhariu, Muslimi dhe tjerë nga Tarik ibënShihabi, se ka shkuar një jehudi tek Omer ibën Hatabi radijallahu anhu dhe i ka thënë: O prijës i besimtarëve, ju po lexoni një Ajet nga Libri juaj, që po të kishte zbritur tek ne jehudët do ta merrnim atë ditë për festë. Omeri radijallahu anhu tha: E cili Ajet? Tha: thënia e Allahut: **“...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe.”** Omeri tha: Pasha Allahun, unë e di ditën në të cilën i ka zbritur Pejgamberit të Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* ajeti dhe po ashtu çastin se kur i ka zbritur. Në ditën

e Arafatit, në ditën e xhuma.”

Allahu i Madhëruar me këtë Pejgamber e ka plotësuar fenë dhe të gjitha gjërat që janë hallall, të lejuara, i tregoi dhe të gjitha gjërat që janë haram, të ndaluara i tregoi. E kumtoi fenë me amanet dhe besnikëri; me saktësi dhe drejtësi. Me saktësi në lajme dhe me drejtësi në urdhra dhe ndalesa, siç ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Fjalët e Zotit tënd janë plot të vërteta** (çka lajmërojnë) **dhe plot të drejta** (çka gjykojnë).” Prandaj kur ka thënë Allahu i Madhëruar: **“...zgjodha për ju Islamin fe.”** d.m.th., edhe ju o besimtarë të jeni të kënaqur me këtë fe meqë Allahu ua ka zgjedhur dhe është i kënaqur me te, u ka dërguar Pejgamberin më të dalluar, ua ka zbritur Librin më të famshëm. Pas këtij Ajeti besimtarët muslimanë nuk kanë më nevojë për ndonjë shtesë kurrë. Allahu e ka plotësuar fenë dhe nuk i mungon fesë islame asgjë, Ai është i kënaqur me këtë fe dhe nuk do ta urrejë asnjëherë. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *Feja islame është ndërtuar mbi pesë shtylla: dëshmia se nuk ka zot tjetër përpos Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe vizita e Qabes.* Ndërsa Allahu për këtë fe ka thënë: **“Feja e pranueshme tek Allahu është Islami,...”** (Ali Imran 19). Sheukani po ashtu thekson se ka si qëllim edhe ngadhënjimin e fesë islame dhe muslimanëve ndaj feve të tjera të kota, siç ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre, po Allahu e plotëson** (e përhap) **dritën e vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët. Ai** (Allahu) **është që e çoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fé të vërtetë, për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë.”** (Saf 8, 9). Ibën Kethiri dhe mufesirë të tjerë thonë se plotësimi që është përmendur në ajet ka të

bëjë edhe me atë, se pas këtij ajeti nuk ka zbritur më ajet me dispozita rreth hallallit dhe haramit.

Allahu i Madhëruar e ka përsosur këtë fe dhe vetëm kjo është e pranuar tek Ai, prandaj ata që kërkojnë fe tjetër, apo sistem tjetër të jetës me rregulla të shpikura nga njerëzit, kanë për të dështuar dhe në Ditën e Gjykimit do të dëshpërohen. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrësi nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.”*** (Ali Imran 85).

Me këtë fe dhe sipas kësaj feje Allahu do t’i vlerësojë veprat dhe do t’i peshojë në Ditën e Gjykimit, ndërsa jomuslimanëve nuk do t’u peshojnë veprat as sa një pendël dhe as nuk iu vendosen në peshore. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zotit të tyre, as takimin (ringjalljen) e Tij, prandaj veprat e tyre shkuar huq dhe në Ditën e Gjykimit atyre nuk do t’u japim kurrfarë vlere.”*** (Kehf 105).

Këtë ajet madhështor duhet ta kenë parasysh muslimanët, se feja e tyre është e përsosur me rrugën e vahjit, shpalljes dhe se Allahu nuk ua ka lënë këtë gjë në dorë krijesave, prandaj çdo gjë që shpikin në fe ajo është e refuzuar. I Dërguari i Allahut ka thënë: *Kush vepron ndonjë vepër që nuk i takon fesë sonë ajo është e refuzuar.* Risitë apo bidatet janë një gjë e dëmshme për umetin musliman dhe nuk ka bidat të mirë, sepse Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *çdo bidat është dalalet (devijim).* Ata që shpikin bidate nuk e kanë kuptuar ende ajetin kuranor: ***“...Sot përsosa për ju fenë tuaj,...”***, ata i bie sikur të thonë: o Zot ndoshta ke harruar ndonjë gjë, ndoshta Pejgamberi yt ka harruar të kumtojë ndonjë gjë, e bëjnë kinse sikur dinë dhe shpikin gjëra të reja në fe, çka nuk

janë prej fesë dhe pastaj pretendojnë, se kështu është mirë. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Zoti yt nuk është që harron.”*** (Merjem 64).

Abdullah ibënMesudi ka thënë: Ajo që ka qenë fe në kohën e të Dërguarit *sal-lallahu alejhi ue selem* edhe sot është fe, e ajo që atëherë nuk ka qenë fe, nuk është edhe sot, edhe pse njerëzit e bëjnë këtë.

Shtojcë

Allahu i Madhëruar në këtë ajet ka përmendur se është i kënaqur që feja jonë të jetë Islami. Mirëpo ndonjëherë hasim edhe disa njerëz nga rrethi i muslimanëve, por janë disi të mërzitur, të dëshpëruar, e ndiejnë veten të ngushtuar vetëm pse janë muslimanë. Këtë e thonë se në ditët e sotme muslimanët qenkan të prapambetur, ndërsa jo-muslimanët (shpesh i theksojnë të krishterët) kanë përparuar në fushën e teknikës shumë. Ne mund t’i themi se nëse ndonjëri e ka këtë ndjenjë dhe i intereson përparim teknik, atëherë sot mund të bëhet shumë lehtë “i përparuar”, vetëm le të vendosë në qafë një kryq dhe ja menjëherë radhitet te “të përparuarit”, po le ta dijë se Allahu për jobesimtarët ka thënë: ***“...nuk do të hyjnë në xhenet deri sa të përbijë deveja nëpër vrimën e gjilpërës...”*** (Araf, 40).

Allahu i Madhëruar këtë dynja ia jep kujtdo që e dëshiron atë, por Ahiretin gëgjësisht xhenetin ia jep vetëm atij që ka besuar dhe i është përmbytur fesë islame, fe të cilën e ka përsosur, ia ka plotësuar begatitë dhe njëkohësisht është i kënaqur me të. ■

PO UA LË AMANET DY GJËRA


Ebu Hurejre na përcjell, se i Dërguari, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë:
“Unë kam lënë pas vetes dy gjëra, të cilat nëse i pasoni kurrë nuk do të devijoni, ato janë: Libri i Allahut dhe Suneti im.”

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Zinxhiri i hadithit:

Këtë hadith e shënon Maliku në Muveta nr. 1395, transmetimi i tij është i pa cekur me sened të plotë d.m.th. ka ndërprerje në sened, Hakimi në Mustedrek, nr. 291, të cilin edhe e saktëson e shënon edhe Darekutni në Sunenin e tij, nr. 4665, Bejhekiu në Sunen Kubra, të gjithë nga Ebu Hurejre. Tek Hakimi në një transmetim përmendet edhe nga Ibën Abasi, hadithi tek disa dijetarë të tjerë përmendet edhe nga Enes ibën Maliku, Amër ibën Aufi, Ebu Seid Hudriu dhe Enes ibën Maliku. Hadithin e përmendin edhe shumë dijetarë të tjerë më të vonshëm se këta që përmenda, por senedet e tyre nuk çojnë peshë në ndërrimin e dispozitave të hadithit nga aspekti i pranimit apo refuzimit.

Rreth këtij hadithi flet gjerësisht hoxha i nderuar Albani, Allahu e mëshiroftë, në librin



e tij: “Silsile sahiha” (Vargu i haditheve të sakta), i mbështetur në shumë tekste të ngjashme, analiza dhe meditime të tij, ai në fund arrin në përfundimin, se hadithi në fjalë arrin në gradën e haditheve të sakta. (Për më gjerësisht kthehu tek libri i tij i lartpërmendur vëllimi 4 fq. 355)

Atë e saktëson para Albanit edhe imam Dhehebiu, gjithashtu të njëjtin mendim e mban edhe dijetari tjetër shqiptar Abdulkadër Arnauti, Allahu i mëshiroftë të gjithë, në librin e recensuar nga ai me titull: “Xhamiul usul”. Ndërsa Ibën Haxheri hadithin e konsideron të dobët. Disa dijetarë të tjerë hadithin sipas senedit e konsiderojnë të dobët, por të saktë sipas kuptimit të tij. Bazuar në këtë që u tha më sipër arrijmë në përfundimin, se hadithi në bazë të zinxhirëve të tij të ndryshëm të transmetuar e arrin gradën e hadithit të mirë, por bazuar në tekstin e tij, i cili theksohet në shumë vende në Kuran, pa dyshim që teksti i tij është i saktë. Pasimin e Kuranit dhe Profetin Muhamed, sal-lallahu alejhi ue selem,

Allahu e përmend në shumë vende me fjalën: **“Respektojeni Allahun dhe të Dërguarin e Tij”** që do të thotë: “Respektojeni Kuranin dhe Sunetin”. Allahu e di më së miri!

Komentimi i hadithit:

Hadithi tregon rëndësinë e pasimit të Kuranit dhe Sunetit të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, pasim ky i cili bëhet shkak për shpëtim në këtë botë dhe në botën tjetër. Me këtë hadith besimtarët këshillohen përmes Profetit të tyre, që të pasojnë dy shpalljet e Zotit. Them dy shpalljet, sepse si Kurani ashtu edhe Suneti janë shpallje nga Allahu e jo të mendojë dikush se hadithi është thjesht fjalë dhe mendim profetik, i një njeriu i cili mund t’ia qëllojë, por edhe mund të gabojë. Përkundrazi fjalët e tij janë shpallje nga Zoti i tij përmes të cilave Allahu adhurohet, si dhe pasimi i të cilave është farz. Argument që aludon në faktin se fjalët e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, janë shpallje është ajeti kuranor, ku Zoti thotë: **“Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij.”** (Nexhëm, 3-4) Pra, pasi u vërtetua se fjalët e tij janë shpallje, atëherë vjen urdhri i dytë, apo hapi tjetër ai se këto mësimet profetike janë detyrim që të pasohen, në to nuk ka zgjedhje mes faktit dua apo nuk dua ta pasoj. Allahu e tregon mjaft qartë në shumë argumente diçka të tillë. Këtu vlen të veçojmë fjalën e Tij: **“Atë që ua jep i Dërguari merreni, ndërsa nga ajo që ai ju ndalon largohuni.”** (Hashër, 7).

Hadithi rreth të cilit jemi duke folur është një ndër argumentet e shumta të kësaj teme. Në të Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tregon qartë se cilat janë shkaqet dhe argumentet që duhet t’i pasojë muslimani për të mos devijuar. Ai përmend pjesëzën mohuese: “LEN”, e cila do të thotë: “asesi” dhe përdoret për kohën e tashme dhe atë të ardhmen, pra, me këtë fjalë kuptohet se Profeti, *alejhi salatu ue selam*, tregon se nëse e

“...Hadithi rreth të cilit jemi duke folur është një ndër argumentet e shumta të kësaj teme. Në të Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, tregon qartë se cilat janë shkaqet dhe argumentet që duhet t’i pasojë muslimani për të mos devijuar...”

pasoni Kuranin dhe Sunetin, atëherë do të garantoheni nga devijimi në të gjitha kohët, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen.

Një stil të tillë e përdori dhe me foljen: “Ebeden”, e cila do të thotë: “përgjithmonë”, ndërsa tani në këtë fjali kuptohet si mohuese me domethënie: “asnjëherë”, prandaj hadithi tregon qartë dhe dy herë radhazi, se kush i pason këto dy burime ai është i udhëzuar dhe i garantuar nga gjuha profetike, se nuk do të devijojë në asnjë mënyrë.

Fjala: **“Libri i Allahut dhe Suneti im”**

Kjo tregon se sa ishte i kujdesshëm Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që të mos keqkuptohej nga askush, përkundrazi ai dëshironte që të ishte i qartë në atë që thoshte. Përmendi Librin e Allahut - Kuranin për të mos menduar njerëzit se udhëzimi gjendet në ndonjë libër tjetër pos tij në libra filozofie apo edhe ata me petk Islam, por me brendësi të devijuar, ndërsa në anën tjetër tha: “Suneti - tradita ime”, pra duhet të pasohet tradita e tij e jo traditat e të tjerëve. Tradita e tij ishte Suneti dhe hadithi i tij, që thamë se ishin me inspirim hyjnor e jo teka të tij, kështu që ajo traditë duhet pasuar përkundër traditave të njerëzve të tjerë, ku shpesh edhe i dëgjon duke brohoritur, se duhet ta pasojmë ndonjë islam tradicional, atë që është i përshtatshëm me traditat vendore, sikur Islami të kishte ardhur për t’i përforcuar këto tradita dhe sikur ato të ishin cekur në

këtë fjalë profetike. Prandaj arrijmë në përfundimin se para fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij nuk vihet asnjë fjalë dhe nëse ndodhë diçka e tillë, atëherë ky do të ishte devijim, qoftë i menjëhershëm apo i mëvonshëm, sepse vetëm duke e pasuar udhëzimin hyjnor në hadith garantohej shpëtimi.

Në vijim le të cekim disa ajete që flasin për këtë çështje:

“Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehenemit; eh, sa vendbanim i keq që është ail!” (Nisa, 115).

“O njerëz! I Dërguari ju ka sjellë të vërtetën nga Zoti juaj, prandaj besoni, se për ju është më mirë! E në qoftë se nuk besoni, ta dini se Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.” (Nisa, 170).

“Me të vërtetë, ata që nuk besojnë, i pengojnë (të tjerët) nga rruga e Allahut dhe e kundërshtojnë të Dërguarin, pasi u është shpjeguar qartë rruga e drejtë, nuk do t'i sjellin Allahut kurrfarë dëmi; Ai do t'i zhvlerësojë veprat e tyre.” (Muhamed, 32).

“O ju që keni besuar! Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit dhe mos i çoni dëm veprat tuaja!” (Muhamed, 33).

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: ‘Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin!’ (Furkan, 27).

“Thuaj: ‘Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit!’ Nëse shmangeni (ta dini se) ai është përgjegjës për detyrën e tij, ndërsa ju për atë që jeni ngarkuar. E, nëse i bindeni atij, do të jeni në rrugën e drejtë, kurse i Dërguari është i detyruar vetëm që të përcjellë qartë (Mesazhin Hyjnor).” (Nur, 54).

“Dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në

Teurat dhe Ungjill. Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.” (Araf, 157).

“Atë ditë, ata që nuk kanë besuar dhe që nuk i janë bindur të Dërguarit, do të dëshironin të rrafshoheshin me tokën, por Allahut nuk mund t'i fshehin asnjë fjalë”. (Nisa, 42).

Disa mirësi të pasimit të Kuranit dhe Sunetit

Përmes këtij pasimi arrihet udhëzimi dhe shpëton nga devijimi i kohëve të ndryshme.

Është shkak për të shpëtuar nga kundërshtimet, kundërthëniet dhe armiqësitë mes vete.

Kush e pason këtë udhëzim i takon grupit, i cili thirret në emër të atij udhëzimi që e pason, ku në këtë rast është emri: “Ehli Suneti dhe Xhemati”.

Pasimi i kësaj rruge të largon nga pasimi i rrugicave të shejtanit, sepse njeriu në të njëjtën kohë nuk mundet t'i pasojë dy rrugë pasi ato janë në kundërshtim mes vete.

Pasimi i kësaj rruge është mundësia e vetme për ta larguar nga muslimanët çdo nënçmim dhe përulje para armikut.

Përmes pasimit të Kuranit dhe Sunetit e gjen ilaçin për çdo sëmundje

Kjo rrugë në vetvete përmbledh të tërë sheriatin për të mos lënë vend për thashetheme.

Përmes saj arrihet çdo lloj devotshmërie dhe gradat e larta të moralit.

Kundërshtimi i këtij udhëzimi është shkak për ta merituar dënimin dhe hidhërimin e Allahut, në këtë dhe në botën tjetër.

Kjo rrugë është e vetmja që garanton hyrjen në Xhenet.

Me të ngjallet shpirti dhe i kthehet jetës kuptimi. ■

SYNETIA NGA ASPEKTI MJEKËSOR

Dr. Schoen konkludon se “synetia e fëmijëve të porsalindur është masë preventive, e ngjashme me vaksinimin, tek e cila nuk paraqiten efekte të padëshirueshme e komplikime dhe përparësitë janë evidente gjatë tërë jetës”.

PRIM. DR. MED. SC. ALI ILIAZI

Synetia (circumcisioni) gjatë historisë ka qenë temë emotive dhe shpesh pre’ e debateve irracionale. Viteve të fundit vërehet dukshëm tek mjekët një trend për kthimin sërish në praktikimin e synetisë tek të porsalindurit. Në dritën e rritjes së numrit të argumenteve shkencore mjekësore, të cilët tregojnë përparësitë e synetisë së fëmijëve meshkuj të porsalindur kolegji pediatrik australian “College of Paediatrics”, në maj të vitit 1966 ka formuluar dhe miratuar qëndrimin e ri për këtë çështje. Në këtë dokument apelohej te mjekët që t’i njoftojnë hollësisht prindërit me përparësitë mjekësore të synetisë së fëmijëve. Këshilla të ngjashme kanë dhënë edhe “Canadian Pediatric Society” dhe “American College of Paediatrics”, në të cilat përshkruhen përparësitë e synetisë. Vlen për ta theksuar mendimin e profesorit të universitetit të Sidnejit, dr. Brian J. Morris, i cili ka bërë hulumtime shkencore në fushën e virusologjisë dhe kancerit të organeve gjenitale.

Profesori i përmendur thotë se nuk është as jehudi apo jurist, kështu që këtë temë e shikon racionalisht. Është fakt i qartë se shkaku i rritjes së rrezikut nga infeksioni të meshkujt e pa bërë synet qëndron në atë se

pjesa e kokës së penisit e mbuluar me lëkurë përshpejton rritjen dhe zhvillimin e mikroorganizmave.

90% të fëmijëve të porsalindur, të viteve 50 dhe 60 të shekullit XX në SHBA dhe Australi, kanë qenë të bërë synet menjëherë pas lindjes. Atëherë synetia bëhej për shkak të higjienës, parandalimit të fimozës (inflamim i lëkurës së kokës së penisit) dhe si parandalim i kancerit të penisit.

Dr. Edgar Schoen, kryetar i Grupit Punues për Synetinë në Akademinë Pediatrike të Amerikës, ka deklaruar se përparësia e synetisë rutinore të fëmijëve të porsalindur, si masë preventive shëndetësore e tejkalon rrezikun e kësaj ndërmarrjeje kirurgjikale. Kështu, në periudhën prej vitit 1985 – 1992, është rritur numri i të bërit synet tek meshkujt në vitet e pjekurisë. Dr. Schoen ka treguar se ekziston lidhja në mes atyre që nuk janë bërë synet dhe inflamacioneve të traktit urinar, si dhe virusit HIV. Në bazë të kësaj dr. Schoen konkludon se “synetia e fëmijëve të porsalindur është masë preventive, e ngjashme me vaksinimin, tek e cila nuk paraqiten efekte të padëshirueshme e komplikime dhe përparësitë janë evidente gjatë tërë jetës”.

Këto përparësi përfshijnë: zvogëlojnë problemin e fimozës, zvogëlojnë balanitisin (inflamimin e kokës së penisit), zvogëlojnë infektimin e kanaleve urinare, zvogëlojnë



“Në bazë të këtyre argumenteve, mund të konkludohet se disa prej sëmundjeve seksuale transmetuese janë shumë më të përfaqësuara te ata që nuk janë bërë synet..”

Sipas një studimi të Wiswellit, ku janë përfshirë 400,000 fëmijë të porsalindur në periudhën kohore prej vitit 1975 deri 1984, është vërtetuar se ata që nuk janë bërë synet, 11 herë më shpesh janë sëmurë nga infeksionet e traktit urinar. Studimet e bëra në vitin 1982 kanë treguar se 95% të të gjitha komplikimeve të rrugëve urinare tek të porsalindurit janë paraqitur tek fëmijët e pa-bërë synet.

problemet gjatë ereksionit në pubertet, zvogëlojnë sëmundjet seksuale përcjellëse, parandalimin e kancerit të penisit dhe zvogëlimin e problemeve dhe infektiveve urinare në pleqëri.

Edhe një autoritet në këtë lëmi është dr. Tom Wiswell, i cili thotë: “Si mjek fëmijësh për shumë kohë kam qenë kundërshtar i synetisë... por tani e kam ndryshuar mendimin tim”.

Rritja e nivelit të kortizolit gjatë dhe pas synetisë tregon se fëmija i porsalindur e regjistron ndërmarrjen kirurgjikale, por kjo dhembje afatshkurtër përballohet më lehtë, sesa kur mendohen dhembjet e shkaktuara nga sëmundjet tek ata që nuk janë bërë synet.

Anestezia lokale në formë yndyre zvogëlon dhembjen tek bebja, ndërsa disa prej tyre nuk kanë dhembje, bile edhe kur ndërmarrja është kryer pa anestezi. Lëndë hulumtimi ka qenë edhe rreziku lidhur me synetin. Në spitalet e armatës amerikane në mes viteve 1980 – 1985 kanë lindur 136.000 fëmijë, dhe prej tyre 100,000 janë bërë synet. Tek 193 veta (0, 19%) janë shkaktuar komplikime, të cilat nuk kanë përfunduar me vdekje. Efekte psikologjike pas synetisë nuk ka pasur.

Një studim i Robertsit ka treguar se 4% e fëmijëve të pa-bërë synet kanë inflamim të traktit urinar, ndërsa 0,2% të fëmijëve të bërë synet. Te 23% të infektuar me bakterie inflamimi ka kaluar në veshka, duke shkaktuar pielonefritis (inflamim i veshkave).

Të gjitha këto edhe studime të tjera tregojnë përparësitë e synetisë tek fëmijët, me qëllim që të reduktohen sëmundjet e traktit urinar. Disa studime kanë treguar se synetia edhe te meshkujt 30 vjeçar, redukton sëmundjet e traktit urinar. Me argumentimin se bakteriet *Escheria coli*, të afta që të strehohen në lëkurën e kokës së penisit shkaktajnë infektimet më të shpeshta të traktit urinar plotësohet një kriterium i kauzalitetit të ndërsjellë. Komplikimet e sëmundjeve të rrugëve urinare janë: ndërprerja e punës së veshkave, inflamimet kronike të veshkave deri te insuficienca renale. Është vërtetuar se edhe me masat më të rrepta higjienike, nuk mund të

mënjahen bakteriet nën lëkurën e kokës së penisit. Studimet e mëhershme kanë treguar shkallën e lartë të triperit, uretritit (inflamim i këndit urinar) tek ata që nuk janë bërë synet. Edhe rezultatet e studimeve të reja kanë treguar të njëjtën gjë.

Në një studim të vitit 1943, që është bërë në Kanada vërtetohet se rreziku nga sifilizi te meshkujt e pa-bërë synet është 9 herë më i madh, ndërsa triperit (gonorreja) 3 herë më i madh se tek ata që janë bërë synet. Në "University of West Australia", një studim i vitit 1983 ka treguar se rreziku nga sëmundja e herpesit gjenital dhe infektimi me gonokok është i dyfishuar, ndërsa infektimet e organeve gjenitale dhe sifilizi pesëfishohen në krahasim me meshkujt e bërë synet. Një studim nga Australia në vitin 1992 na tregon se meshkujt e pa-bërë synet sëmurën më shpesh nga chlomidija (inflamim i specifik i kanalit urinar, adds ratio 1,3) dhe triperi (adds ratio 2,1). Në bazë të këtyre argumenteve, mund të konkludohet se disa prej sëmundjeve seksuale transmetuese janë shumë më të përfaqësuara te ata që nuk janë bërë synet.

KANCERI I PENISIT

Paraqitja e kancerit të penisit në SHBA është 1: 100,000 meshkuj (750 – 1000 raste gjatë vitit) dhe shkalla e vdekshmërisë qëndron në mes 25 – 33%. Kanceri i penisit përfshin 1% të të sëmurëve nga kanceri te amerikanët. Këtu duhet marrë parasysh fakti se në SHBA ekziston një përqindje e madhe e meshkujve të bërë synet. Sipas një studimi të publikuar në revistën "Australasian Radiology" në vitin 1990, 60% e të sëmurëve nga kanceri i penisit kanë qenë mbi 60 vjeç. Në pesë studime të mëdha të bëra në SHBA nga viti 1932, në mesin e të sëmurëve nga kanceri i penisit nuk ka qenë asnjë mashkull, i cili si i porsalindur është bërë synet. Në periudhën prej vitit 1960 deri në 1966 në

“Në mesin e vozitësve të kamionëve, të cilët kanë më shpesh kontakte me prostitutat është vërejtur një shkallë më e madhe e infeksionit me virusin HIV, tek ata që nuk kanë qenë të bërë synet...”

Australi janë shënuar 78 raste vdekjeje nga kanceri i penisit dhe vetëm dy raste vdekjeje si pasojë e komplikimit të synetisë. Në kohën e sotme rastet e vdekjes si pasojë e synetisë janë gati të panjohura. Në "Peter McCallum Cancer Institute", në periudhën prej vitit 1954 deri në 1982 janë shënuar gjithsej 102 raste të kancerit të penisit. Kështu që synetia e fëmijëve të porsalindur është preventiva më e mirë.

KANCERI I GRYKËS SË MITRËS TE FEMRAT ME PARTNERËT QË NUK JANË BËRË SYNET

Shumë studime tregojnë për rritjen e numrit të sëmurëve nga kanceri i grykës së mitrës te gratë, tek të cilat një ose më shumë partnerë seksualë nuk kanë qenë të bërë synet. Një studim në 5000 raste të kancerit të grykës së mitrës dhe 300 raste të kancerit të penisit, të bërë në qytetin indian Madras, në periudhën prej 1982 deri 1990, ka treguar se kanceri i grykës së mitrës te myslimanet ka qenë shumë i rrallë, në krahasim me gratë indiane dhe të krishtera, ndërsa në mesin e të sëmurëve me kancer të penisit nuk ka qenë asnjë mysliman. Në studimin tjetër në vitin 1993 të 1107 grave indiane, të sëmura nga kanceri i grykës së mitrës tregoi se rreziku ka qenë katër herë më i madh te meshkujt e pa-bërë synet. Studimi tjetër mbi llojet e kancereve të ndryshëm në Kashmir i bërë në vitin 1993 ka konkluduar, se synetia e bebeve të porsalindura tregon për paraqitjen shumë të rrallë të kancerit të grykës së mitrës.

VIRUSI HIV

Në Afrikë, varësisht nga shtetet, gati 10% e popullatës është e infektuar me virusin HIV. Në Nairobi, në një studim ku janë përfshirë 340 meshkuj të shëruar nga sëmundjet seksuale transmetuese (SST), është vërejtur se infektimi me virusin HIV ka qenë tri herë më i madh te meshkujt, që nuk kanë qenë të bërë synet. Diçka më vonë hulumtimet në 409 grupe etnike afrikane, që gjenden në 37 shtete ka treguar korrelacionin në mes meshkujve të pa-bërë synet dhe shkallës së lartë të AIDS-it. Në revistën “International Journal of Epidemiology”, dr. Moses shkruan se studimet në mesin e 700 fiseve afrikane, në 140 vende të ndryshme, kanë treguar një paraqitje tejet të vogël të virusit HIV në vendet ku praktikohet synetia e fëmijëve të porsalindur.

Në mesin e vozitësve të kamionëve, të cilët kanë më shpesh kontakte me prostitutat është vërejtur një shkallë më e madhe e infeksionit me virusin HIV, tek ata që nuk kanë qenë të bërë synet.

Një rezultat interesant ka sjellë një studim nga Afrika Perëndimore: vetëm meshkujt që kanë qenë të bërë pjesërisht synet (tek të cilët ka mbetur një pjesë e lëkurës së kokës së penisit), janë sëmurë më shpesh nga virusi HIV – 2, sesa meshkujt tek të cilët lëkura e kokës së penisit ka qenë tërësisht e mënjanuar. Këto rezultate kanë qenë arsye që shkencëtarët Moses dhe Caldwell të propozojnë që synetia të shërbejë si strategji e rëndësishme në reduktimin e AIDS – it. Si shkas për mundësinë më të madhe të infektimit me virusin HIV te meshkujt e pa-bërë synet, supozohet të jetë sekreti (smegma) nën lëkurën e kokës së penisit dhe sekreti vaginal te femra. Ndërsa koka e penisit pa lëkurë tek meshkujt e bërë synet vështirëson transmetimin e sëmundjes.

KONKLUDIM

Mosbërja synet:

1. tek meshkujt është faktori më i madh i rrezikut për infektimin me virusin e HIV – it;

2. është shkak që 12 herë të jetë rreziku më i madh në infektimin e rrugëve urinare, të cilat tek fëmijët e porsalindur mund të shkaktojnë edhe vdekje;

3. një në përafërsisht 600 – 900 të meshkujve të pa-bërë synet vdes nga kanceri i penisit;

4. mosbërja synet është shkak i inflamimit të kokës së penisit (balanitis) dhe tkurrjen e lëkurës (fimoza). Afro 18% e meshkujve të fëmijët e pa-bërë synet deri në moshën 8 vjeçare kanë këto komplikime, të cilat tek ata që janë të bërë synet nuk janë të njohura;

5. gratë, bashkëshortët e të cilave nuk janë të bërë synet sëmuren më shpesh nga kanceri i grykës së mitrës.

ASPEKTI SHOQËROR

Në fund po sjellim disa aspekte të lidhura me çështjen e synetisë në Australi. Në një studim mbi meshkujt e pa-bërë synet dhe partneret e tyre, shkencëtari James Badger nga Sidnei, i cili e numëron veten me qëndrim neutral për sa i përket çështjes së synetisë, ka zbuluar sa vijon:

18% e meshkujve të pa-bërë synet, prapëseprapë më vonë gjatë jetës së tyre kanë vendosur për t'u bërë.

21% të cilët nuk janë bërë synet kanë thënë se do të kishin dëshirë që të ishin bërë synet si fëmijë.

Meshkujt e bërë synet kanë qenë seksualisht më aktivë, se ata që nuk kanë qenë të bërë synet. Gratë e meshkujve të bërë synet kanë pasur tre herë më tepër orgazëm se sa gratë, burrat e të cilave nuk kanë qenë të bërë synet. Në fund, mund të themi se praktikimi i synetisë si një vepër e shëndetshme e zbatuar nga Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë me të, e kanë vërtetuar shkencëtarët bashkëkohorë pas 14 shekujve si të tillë. ■

PERCEPTIME NDAJ LUMTURISË

Lumturia nuk prehet në pasuri, autoritet, shëndet, altruizëm etj. Ajo prehet vetëm në një gjë: në mendimin pozitiv të njeriut se ai është i lumtur

ABDULKERIM BEKKAR

Njerëzimi ka përvoja të shumta në perceptimin e lumturisë dhe të haresë. Secili prej nesh ka ndjenjat, emocionet, mendimet dhe iluzionet e tij për këtë çështje. Është e udhës që të paraqesim thëniet e disa dijetarëve lidhur me njeriun e lumtur dhe jetën e rehatshme.

Njëri prej tyre thotë: Lumturia reale fshihet në vlerësimin e dhuntive të të tjerëve dhe gëzimin për gëzimet e tyre. Për këtë arsye njeriu më i lumtur është ai që sa herë e shikon një njeri të gëzuar ndien gëzim, që depërton në brendësinë e vet. Pasi të gëzuarit janë të shumtë në këtë botë ai do të gjejë gjithmonë një burim të ri për ta ngazëlluar shpirtin.

Një mendimtar tjetër shikoi anën tjetër të medaljonit dhe tha: “Mendjet e ndritura nuk përfetojnë kurrë gëzim, për shkak se ndjejnë tek të tjerët mungesën e lumturisë. Sipas tyre lumturia është pjesë e egoistëve!

Mendimtari i tretë thotë: “Shtoj

inJORANCËN TËNDE QË TA ARRISH LUMTURINË. Me këtë ai ka si qëllim ata që i shqyrtojnë gjërat me saktësi të plotë dhe e përcjellin aktualitetin, në të cilin gjejnë shumë parregullsi dhe vështirësi të dhimbshme, që ua turbullojnë mendjen dhe zemrat. Për këtë injoranca do t'i mbrojë prej tyre. Mirëpo një numër i madh njerëzish të mençur e konsiderojnë se njeriu gjen kënaqësi të madhe në njohjen dhe zbulimin e shkaqeve dhe faktorëve të dukurive të ndryshme dhe të kuptuarit e raporteve që i lidhin gjërat. Dhe në këtë kontekst përmendin se i është thënë një herë Ebu Bekër el-Havarizmiut në prag të agonisë së vdekjes: Cila ishte kënaqësia jote më e madhe në këtë botë? Ai u përgjigj: “Shikimi në faqet e librave!”

Ka disa që mendojnë se lumturia fshihet në mënyrën e perceptimit të gjërave dhe shpjegimit të aktualitetit, si dhe reagimit tonë ndaj ngjarjeve të ndryshme. Për arsye se për çdo gjë në jetën tonë ka njëzet hije, dhe shumica e tyre janë si produkt i shpikjeve të vetë njerëzve, këtë thënie e mbështet

“A është thënë një herë Ebu Bekër el-Havarizmiut në prag të agonisë së vdekjes: Cila ishte kënaqësia jote më e madhe në këtë botë? Ai u përgjigj: “Shikimi në faqet e librave!”..”

fuqishëm fjala e të Dërguarit të Allahut, i cili thotë: *“Çudi është me punën e besimtarit. E gjithë veprimtaria e tij është hair. Nëse i ndodh diçka e gëzueshme, falënderon Allahun dhe është hair për të. E nëse e godet ndonjë e keqe, bën durim dhe prapë është hair për të. Kjo ndodh vetëm te besimtari.”* Muslimi, nr. 7425

Kështu, me përbuzjen e të mirës, ai e shndërron atë të mirë në të keqe dhe e bën përfundimin saj të dhimbshëm. E njëjta gjë është nëse ankohet dhe vajton për shkak të fatkeqësisë që e ka goditur atë, ky veprim e privon muslimanin nga shpërblimi i saj, e në të njëjtën kohë me këtë vajt看 ai nuk ndryshon asgjë.

Është edhe një mendim i veçantë në lidhje me këtë temë mbështetësit e të cilit thonë se lumturia në këtë botë nuk është asgjë tjetër vetëm se një fantazmë, e cila dëshirohet, shpresohet dhe ndiqet nga njerëzit. Nëse u bie në dorë dhe bëhet e prekshme, atëherë dëshpërohen dhe mërzhiten, pastaj fillojnë të kërkojnë diçka tjetër. Në bazë të këtij perceptimi, lumturia e njerëzve fshihet në ndjekjen e asaj që mendojnë se është shkak që i bën ata të lumtur, e jo që të kënaqen me të.

Disa njerëz të dijshtë konsiderojnë se njerëzit më të lumtur janë ata që zbulojnë se çka duhet vepruar dhe e bëjnë atë. Pra, ata kanë ngjashmëri të fortë apo më mirë të themi të plotë në mes teorisë dhe praktikës.

Ata gjatë këtij procesi të zbulimit ndjejnë vetëbesim dhe janë të sigurt në rrugëtimin e tyre.

Ekziston edhe një mendim aktual i pazakonshëm i cili është larg çdo kriteri objektiv, këtë mendim e parasheh pjesëtari i saj, se lumturia nuk prehet në pasuri, autoritet, shëndet, altruizëm etj. Ajo prehet vetëm në një gjë: në mendimin pozitiv të njeriut se ai është i lumtur.

Lumturia është ndjenjë e rehatisë, relaksimit e çlodhjes dhe pjesëmarrje në jetën e përditshme në mbarësi. Nëse dikush mendon se e zotëron një ndjenjë të tillë, atëherë ai është i lumtur pa marrë parasysh se çfarë thuhet rreth kushteve dhe parimeve të lumturisë. Epërsia e këtij mendimi mbështetet në faktin, se nuk ka mundësi t'i thuhet dikujt që shpreh ndjenjën e tij të lumturisë, se je fatkeq, i dëshpëruar dhe i shqetësuar, pa marrë parasysh provat dhe argumentet që dëshmojnë, dëshpërimin dhe shqetësimin e tij.

Këto mendime të shumta për lumturinë na përkujtojnë ngjarjen e atyre të verbërve, ku secili prej tyre vendosi dorën e tij në një pjesë të elefantit, duke menduar se ajo pjesë që po prek simbolizon të tërë elefantin, njëri preku veshin, tjetri preku hundën i treti preku dhëmbin dhe i fundit këmbën. Pastaj secili filloi ta përshkruaj elefantin nga këndvështrimi i tij dhe në fund dolën me përshkrime të çuditshme dhe krejt të kundërta.

Mendimet e lartpërmendura për lumturinë të gjitha janë të sakta, nëse themi se ato sqarojnë disa arsye dhe elemente të lumturisë. Ato po ashtu mund të konsiderohen të gabuara nëse pretendojmë se ato e sqarojnë fenomenin e lumturisë në mënyrë të plotë. ■

përktheu A. TERZIQI



hapja e derës së bidateve të mira do të çonte deri te ndryshimi i fesë dhe do të hapte derën e epsheve dhe mendjes së lirë, sepse çdo bidatçi me veprat e tij dëshiron të thotë: ajo që ua kam sjellë është punë e mirë, atëherë mendimin e kujt duhet të marrim dhe cilin duhet të pasojmë.

MUHAMED IBËN SALIH MUNEXHID

Pyetje: Dua të di ç'është bidati? Shpeshherë dëgjoj disa njerëz, të cilët shumë punë i emërtojnë si bidate dhe kjo gjë më huton, pastaj a nuk ka një hadith në të cilin i Dërguari i Allahut ka thënë që “çdonjëri, i cili sjell një punë të re të dobishme shpërblehet për të”? Nëse është kështu atëherë pse të gjitha bidatat konsiderohen të urryera?

Përgjigje: Falënderimi i takon Allahut... Së pari duhet të dimë kuptimin e bidatit në shariat. Përkufizimi i bidatit është: “**rrugë e**

shpikur në fe me të cilën synohet adhurimi i Allahut dhe afrimi tek Ai.” Kjo do të thotë se sheriati nuk ka sjell argument për këtë vepër, as në Kuran, as në Sunet dhe as që ka qenë e pranishme në kohën e të Dërguarit apo shokëve të tij. Po ashtu kuptohet qartë nga përkufizimi se shpikjet që s’kanë të bëjnë me fenë nuk përfshihen në konceptin e bidatit, si një gjë e qortuar nga Sheriati.

Për sa i takon problematikës që ke ngritur duke përmendur një hadith, themi që nëse e ke fjalën për hadithin, të cilin e transmetojnë Ebu Hurejre dhe hadithi i Xhabirit, le të shikojmë tekstin dhe kuptimin e tij. Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij,

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

na përcjell se i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Kush bën traditë një punë të mirë dhe të tjerët e pasojnë ai merr shpërblimin e veprës së tij dhe sa shpërblimi i atyre që e pasojnë, duke mos iu pakësuar asnjërit shpërblimi i vet dhe kush bën traditë një punë të keqe pastaj të tjerët e pasojnë ai merr mëkatin e veprës së tij dhe të gjitha mëkatet e atyre që e pasojnë, duke mos iu pakësuar asnjërit mëkati i tij.”* (Tirmidhiu, hasen sahih).

Ky hadith ka një tregim për shkak të të cilit është thënë, si dhe na sqaron shumë për kuptimin e tij. Këtë tregim e ka shënuar Muslimi, i cili e përcjell rastin duke thënë: *“Shkuan disa beduinë tek i Dërguari i Allahut. Ishin të veshur me rrobe të vrazhda. Kur pa gjendjen e tyre të rëndë i nxiti njerëzit për lëmoshë, mirëpo sikur u ngadalësuan (ngurruan njerëzit) dhe kjo gjë u vërejt në fytyrën e tij. Më pas një ensar solli një shportë prej gjetheve, pastaj erdhi një tjetër pastaj vazhduan të tjerët radhazi gjersa shkëlqeu gëzimi në fytyrën e tij. Pas kësaj i Dërguari i Allahut tha: “Kush bën traditë një punë të mirë në Islam dhe të tjerët punojnë me të pas tij i shkruhen atij të gjitha shpërblimet e punëve të tyre pa u mangësuar shpërblimi i tyre”.*

Për të qartësuar edhe më tepër shkakun e këtij hadithi po përmendim transmetimin e Nesaiut, i cili ka shënuar: Ishim tek i Dërguari i Allahut sapo kishte filluar dita. Erdhën disa njerëz të zhveshur, të zbathur... fytyra e të Dërguarit u ndryshua nga mjerimi që pa tek ata. Urdhëroi Bilalin që të thërrasë ezanin, u falën pastaj iu drejtua njerëzve me fjalët nga Kurani: **“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një vete (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju”** dhe **“Kini frikë Allahun dhe le të**

“... I Dërguari na ka lajmëruar se kushdo që bën një bidat në fe, vepra e tij asgjësohet dhe i refuzohet, pra, Allahu nuk ia pranon...”

shikojë çdo shpirt çfarë ka punuar për nesër...”

Jepni qoftë një dinar, një dërhem, rroba, drithë, hurma gjersa ju tha: qoftë edhe një gjysmë hurme. Erdh një njeri me një strajcë që mezi e mbante. Pas tij filluan të japin lëmoshë të tjerët radhazi gjersa u bënë dy grumbuj, njëra me ushqim e tjetra më rroba. Fytyra e të Dërguarit lulëzoi dhe ai tha këto fjalë: “Kush bën traditë një punë të mirë ai merr shpërblimin e veprës së tij dhe shpërblimin e atyre që do të veprojnë si ai pa iu mangësuar askujt shpërblimi i vet dhe ai që bën traditë një punë të keqe ai merr mëkatin e veprës së tij dhe mëkatin e atyre që do të veprojnë si ai pa iu mangësuar asnjërit mëkati i vet.” (Nesaiu)

Nga ky tregim bëhet i qartë kuptimi i fjalëve *“kush bën traditë një vepër të mirë”* d.m.th. kush e ngjall një traditë të Pejgamberit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, apo i udhëzon të tjerët tek ajo vepër, urdhëron në të apo vepron sipas saj dhe të tjerët e pasojnë. Në këtë kuptim vjen edhe hadithi, të cilin e përcjell Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur prej tij: Shkoi një njeri tek i Dërguari i Allahut, i cili i nxiti shokët e tij për t'i dhënë lëmoshë. Njeriu tha: kam këtë e këtë,- pastaj s'mbeti ndonjëri nga të pranishmit pa i dhënë diçka, qoftë pak apo shumë; i Dërguari i Allahut tha: *“Kush nis një punë të hairit e ka shpërblimin e plotë dhe edhe sa shpërblimi i të gjithë atyre që do ta pasojnë, pa iu mangësuar pasuesve shpërblimi i tyre, e kush nis një punë të*

sherrit ai merr mëkatën e plotë dhe mëkatën e atyre që do ta pasojnë, pa iu mangësuar mëkatet pasuesve.” (Ibën Maxhe)

Duke vështuar hadithet e lartpërmendura zhduket çdo mëdyshje, se i Dërguari i Allahut kishte si qëllim lejimin e bidateve në fe, sidomos atë që disa njerëz e quajnë bidat i mirë kjo edhe për këto arsye:

1. I Dërguari i Allahut e përsëriste vazhdimisht fjalën “*çdo gjë e shpikur (në fe) është bidat, çdo bidat është devijim dhe çdo devijim përfundon në zjarr.*” Nesaiu në Sunenin e tij emërtoi një kapitull “Namazi i dy bajrameve, kreu: Fjalët e hutbes. Qëllimi i tij është të theksojë, se i Dërguari i Allahut sa herë që mbante një fjalim thoshte: “*Fjalët më të mira janë fjalët e Allahut, udhëzimi më i mirë është udhëzimi i të Dërguarit. Punët më të këqija janë shpikjet (në fe) dhe çdo shpikje është bidat...*” (Muslimi) nëse çdo bidat është devijim, si mundet që dikush të thotë se ka bidate të mira. Vërtet kjo thënie e kundërshton atë që i Dërguari e rrënjoste vazhdimisht dhe tërhiqte vërejtjen prej saj.

2. I Dërguari na ka lajmëruar se kushdo që bën një bidat në fe, vepra e tij asgjësohet dhe i refuzohet, pra, Allahu nuk ia pranon, siç është përmendur në hadithin e Aishes, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, e cila përcjell se i Dërguari i Allahut ka thënë: “*Kush shpik në fenë tonë diçka që s’është prej saj, ajo vepër refuzohet.*” (Buhariu dhe Muslimi)

3. Ai që shpik bidate në fe vepra e tij doemos nënkupton disa gjëra, të cilat secila prej tyre është më e keqe se tjetra, prej tyre:

- akuza se feja është e mangët dhe se Allahu nuk e ka përkryer dhe se ka hapësirë për të shtuar në fe. E tërë kjo bie ndesh me fjalën e Allahut “*Sot ua përsosa fenë, ua plotësova begatinë time dhe jam i kënaqur që Islami të jetë feja juaj.*”

- feja ka qenë e mangët qysh prej kohës së të Dërguarit e deri sa ka ardhur ky bidatçi për ta përkryer prej vetvetes.

“...Pranimi i bidateve nënkupton doemos shpifjen ndaj të Dërguarit me dy gjëra: ose ai ka qenë injorant për këto bidate të mira!! Apo i ka ditur, mirëpo i ka fshehur dhe e ka mashtruar umetin...”

- pranimi i bidateve nënkupton doemos shpifjen ndaj të Dërguarit me dy gjëra: ose ai ka qenë injorant për këto bidate të mira!! Apo i ka ditur, mirëpo i ka fshehur dhe e ka mashtruar umetin.

- shpërblimi i këtyre bidateve i ka ikur të Dërguarit, shokëve të tij dhe të gjithë gjeneratave të para, deri sa ka ardhur ky bidatçi dhe ta fitojë atë shpërblim. Edhe pse është dashur që ai të thotë kështu: sikur ky bidat të ishte një vepër e mirë do më paraprinin besimtarët.

- hapja e derës së bidateve të mira do të çonte deri te ndryshimi i fesë dhe do të hapte derën e epsheve dhe mendjes së lirë, sepse çdo bidatçi me veprat e tij dëshiron të thotë: ajo që ua kam sjellë është punë e mirë, atëherë mendimin e kujt duhet të marrim dhe cilin duhet të pasojmë.

- praktikimi i bidateve çon deri te vdekja e Suneteve siç kanë thënë **të parët**: kur ngjallet një bidat vdes një sunet. Duhet të jetë e kundërta.

Lusim Allahun e Madhëruar që të na largojë nga epshet që na devijojnë, si dhe nga sprovat qofshin të hapura apo të fshehta. Allahu e di më së miri. ■